

RAPORTI VJETOR PËR KRIMET NGA URREJTJA

NË VITIN
2016

KRIME NGA
URREJTJA



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup. Misioni i përmbahet vendimit PC.DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë,
përfaqësuar nga Kryetari prof. dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktor:

Uranija Pirovska

Autorë:

dr. Voislav Stojanovski

mr. Angela Saplieva

Sanja Barlakovska



**КОМИТЕТ ЗА ЧОВЕКОВИ
ПРАВА НА РЕПУБЛИКА
МАКЕДОНИЈА**

Naum Naumovski Borçe 83
1000, Shkup
Tel: +389 (0)2 3119 073
Faks: +389 (0)2 3290 469
Web: www.mhc.org.mk
E-mail: helkom@mhc.org.mk

PËRMBAJTJA

1. PËR PROJEKTIN	62
2. METODOLOGJIA	63
2.1 Ndjekja e medieve nacionale elektronike dhe të shtypura	63
2.2 Sigurimi i ndihmës juridike pa pagesë për viktimat	63
2.3 Ndjekja e rasteve gjyqësore të krimeve nga urrejtja	63
2.4 Informimi i Misionit të OSBE-së në Shkup për incidente dhe krime nga urrejtja ...	64
2.5 Mirëmbajtja e ueb-faqes interaktive për paraqitje të krimeve nga urrejtja	64
3. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE	65
3.1 Konteksti	65
3.2 Numri i incidenteve	65
3.3 Lloji i veprave penale	66
3.4 Incidente sipas lokacionit	67
3.5 Incidente sipas muajit	68
3.6 Incidente nga motivimi i njëanshëm	68
3.7 Viktima dhe kryerës	68
3.8 Statusi i rasteve	69
4. AKTIVITETET TË EKIPIT TË PROJEKTIT	70
4.1 Ndjekja e medieve nacionale elektronike dhe të shtypura	70
4.2 Sigurimi i ndihmës juridike pa pagesë për viktimat e krimeve nga urrejtja dhe ndjekja e seancave gjyqësore	70
4.3 Informimi i OSBE-së/ODIHR-it mbi incidentet dhe krimet nga urrejtja	71
4.4 Mirëmbajtja e ueb-faqes interaktive për paraqitjen e krimeve nga urrejtja	72
4.5 Kontributi në 8 punëtori për trajnim të policisë	72
4.6 Shënimi i 22 Korrikut – Dita Evropiane e Viktimave nga Krimet e Urrejtjes	72
5. KONKLUZA	73
6. REKOMANDIME	74
ANEKSI	75
Incidente nga urrejtja në vitin 2016	75

1. RRETH PROJEKTIT

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të kontribuojë në përgatitjen e mekanizmave efektivë dhe të qëndrueshëm të mbizotërimit të së drejtës dhe sistemit juridik që do t'i mbrojnë të drejtat e të gjithë qytetarëve/qytetareve. Në këtë drejtim, OSBE-ja vazhdoi t'i ndihmojë pjesëmarrësit në nivel nacional në miratimin dhe vendosjen e përmirësimeve të legjislacionit që i rregullon krimet nga urrejtja dhe gjuha e urrejtjes, t'i përmirësojë kapacitetet e institucioneve dhe organizatave qytetare relevante për ballafaqim me këto fenomene, ta ngrejë vetëdijen tek opinioni i përgjithshëm dhe ekspertët, mbi pasojat e incidenteve të shkaktuara nga mbajtja e anshmërisë dhe ta zgjerojë shkëmbimin akademik rajonal.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë (KHM) në rolin e partnerit në zbatimin e këtij projekti i zbatoi këto aktivitete në fushën e krimeve nga urrejtja:

1. Ndjekje e mëtejshme e incidenteve / krimeve nga urrejtja me vëmendje të veçantë mbi dhunën në sport, e motivuar nga mbajtja e anshmërisë;
2. Sigurim i ndihmës juridike pa pagesë për viktimat e krimeve nga urrejtja dhe ndjekja e gjyqimeve;
3. Rishqyrtim i krimeve të paraqitura nga urrejtja dhe kontributi për Raportin vjetor të ODHIR-it për krime dhe incidente nga urrejtja në rajonin e OSBE-së për vitin 2015;
4. Mirëmbajtje, azhurnim dhe përkthim i ueb-faqes: www.zlostorstvaodomraza.mk;
5. Kontribut për 8 punëtori me temë mbi krimet nga urrejtja me organizim të Njesisë për zhvillim të policisë në Misionin e OSBE-së, ku i prezantoi qasjet e saja nga vëzhgimet e kryera; dhe
6. Shënimi i Ditës së propozuar për viktimat e krimeve nga urrejtja më 22 korrik dhe organizimi i konferencës për shtyp, si dhe evenimentin “Turli tavë” i cili u mbajt për të tretën herë

2. METODOLOGJIA

2.1 Monitorimi i mediave nacionale elektronike dhe të shtypura

KHM është i parapaguar në një numër gazetash ditore me qasje të ndryshme ideologjike dhe përkatësi të ndryshme politike. Monitorimi i medieve elektronike është bërë në bazë ditore, nëpërmjet dy gjeneratorëve më të popullarizuar të lajmeve nga interneti (www.time.mk dhe www.grid.mk), si dhe duke përdorur opsionet për kërkim të avancuar nën seksionin “Lajme” të www.google.com. Po sa është shënuar një krim apo incident nga urrejtja, KHM ka shënuar titullin e lajmit dhe linkun e internetit dhe e ka botuar te portali i internetit për raportimin e krimeve nga urrejtja -www.zlostorstvaodomraza.mk. Qëllimi kryesor i monitorimit të medieve ka qenë identifikimi i shfaqjeve të mundshme të incidenteve nga urrejtja dhe të kontaktojë viktimat e supozuara për intervistë, si dhe t'u ofrojë ndihmë ligjore pa pagesë apo monitorim të procesit gjyqësor të rastit të tyre.

2.2 Sigurim i ndihmës juridike pa pagesë për viktimat

Kurdo që është identifikuar dhe vendosur kontakti me një viktimë të supozuar, KHM-ja ka ofruar shërbimet e veta për ndihmë juridike pa pagesë. Janë organizuar takime me viktimat dhe familjet e tyre. Takimet janë realizuar ose në zyrat e KHM-së ose në ndonjë lokacion të propozuar nga viktima. Gjatë takimeve është realizuar edhe intervistë. Në rastet në të cilat është supozuar të ketë pasur incident - krim, është marrë deklaratë me shkrim, ndërsa viktima është lutur të plotësojë një formular standard për ndihmë juridike pa pagesë. Përveç kësaj, nga viktimat është kërkuar, gjithashtu, që të dorëzojnë kopje të dokumenteve përkatëse me rëndësi për rastin e tyre. Viktimave u është dhënë mbështetje në formë të inkurajimit, shoqërimit deri në stacionin policor, gjetjen e mbrojtësit i cili do t'i përfaqësonte pa pagesë, plotësimin e fletëparaqitjeve penale, komunikimin me mbrojtësit, të cilët tashmë punojnë në këtë rast dhe shkrimin e shkresave në emër të tyre. Gjithashtu, është ofruar ndjekje e rastit para dhe gjatë gjykimit.

2.3 Ndjekja e rasteve gjyqësore të krimeve nga urrejtja

Monitorimi i procesit nga ana e KHM-së fillon: 1) pas një kërkesë formale për ndihmë juridike pa pagesë të dorëzuar në KHM nga personi në procedurë penale në lidhje me krimet nga urrejtja, dhe 2) pas informatës së marrë nga gjykatat në lidhje me seancën gjyqësore të caktuar dhe seancën gjyqësore në vijim në lidhje me krimet nga urrejtja. Para se të fillojë mbikëqyrësi i KHM-së të realizojë mbikëqyrjen e procesit gjyqësor, që vijon pas kërkesës formale, personi i cili ka dorëzuar kërkesën është lutur që të sigurojë dokumentacionin e plotë në lidhje me rastin e tij/saj (d.m.th. fotokopje të të gjitha dokumenteve juridike të grumbulluara gjatë procedurës në gjykatat në vend apo institucionet e tjera). Pasi janë siguruar dokumentet, është caktuar një këshillues juridik për rastin i cili ka analizuar rastin dhe ka vendosur për veprimet e mëtejshme të cilat duhet të ndërmerren para, gjatë dhe pas procesit gjyqësor. Këshilluesi juridik pastaj ka përgatitur raportet të cilat i referohen gjithë procedurës dhe ka elaboruar se a është kryer procesi në pajtim me normat ligjore. Monitorimi i proceseve gjyqësore i dha mundësi ekipit të vlerësojë mënyrën se si janë trajtuar viktimat në procesin juridik.

2.4 Informimi i Misionit të OSBE-së në Shkup për incidentet dhe krimet nga urrejtja

Hollësitë në lidhje me incidentet, siç janë: përshkrimi i shkurtër, data, koha, lokacioni, burimi i informatave, viktimat) e përfshira, autorët e krimet, statusi i rastit, përgjigja nga autoritetet dhe ndikimi mbi viktimat) dhe mjedisin vendor, janë raportuar rregullisht te Misioni i OSBE-së në Shkup. Raportimi mbi incidentet dhe krimet nga urrejtja është lehtësuar nga krijimi i një ueb-platforme për pasqyrim të hartës së krimeve nga urrejtja. Krahas asaj që mund të ndiqen në internet incidentet dhe krimet nga urrejtja pasi kanë ndodhur, Misioni i OSBE-së merre edhe një raport të përkohshëm dhe një raport final të përgatitur nga KHM-ja. Ky raport final do të shpërndahet me raportin vjetor të ODIHR për krimet nga urrejtja në vendet anëtare të OSBE-së.

2.5 Mirëmbajtja e ueb-faqes interaktive për paraqitje të krimeve nga urrejtja

Ueb-faqja, www.zlostorstvaodomraza.mk, është pajisje interaktive e cila u mundëson qytetarëve të marrin informacione dhe të paraqesin krime nga urrejtja. Faqja përmban një hartë interaktive ku janë pasqyruar lokacionet e përfaqësuara të incidenteve. Në faqen kryesore ka një listë të kategorive të krimeve nga urrejtja dhe motiveve që mbajnë anë, ajo mundëson informacione rreth mënyrës se si mund të paraqesin qytetarët (e-aplikime, twitter, posta elektronike dhe formulari elektronik), dhe në të janë pasqyruar grafikët statistikorë. Gjithashtu, ka dhe PPSH, materiale dhe fjalor ku mund të gjenden informacione në lidhje me projektin, rëndësinë dhe spektrin e krimeve nga urrejtja, si dhe publikime për krime nga urrejtja.

Përveç, në gjuhën maqedonase, faqja është në dispozicion edhe në gjuhën shqipe dhe angleze.

3. REZYME E

QASJEVE KRYESORE


3.1 Konteksti

Faqja e internetit për informim për krime nga urrejtja tregon se vendi ka dërguar statistika për 5 krime nga urrejtja për të cilat ka informuar policinë, prej të cilave për 3 janë ngritur akuza, kurse për dy është shqiptuar dënim. Megjithatë ODIHR tërheq vëmendjen se “Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë nuk informon mbi krimet nga urrejtja, veçanërisht, për rastet e gjuhës së urrejtjes”.¹ Në Raportin e Komisionit të BE-së mbi përparimin e vendit për vitin 2016, thuhet: “Nuk ekziston mbledhje sistematike e të dhënave të paraqitjes, kërkimit dhe ndjekjes së gjuhës së urrejtjes dhe krimeve nga urrejtja. Të dhënat e mbledhura nga shoqëria civile dëshmojnë se pushteti nuk vepron si duhet me krimet e tilla”.² Në vitin 2014 KHM-ja botoi një analizë të veçantë për krime nga urrejtja, të regjistruara gjatë vitit 2013.³ Ajo analizë, së bashku me raportet vjetore mbi krimet nga urrejtja për vitin 2014 dhe 2015⁴ (ky raport dhe ueb-faqja për informim për krime nga urrejtja – www.zlostorstvaodomraza.mk), janë përpjekjet e para konkrete që të hartohet, ndiqet dhe të informohet për incidente të krimeve nga urrejtja në vend.

3.2 Numri i incidenteve

Në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2016 janë rregjistruar gjithsej 70 krime nga urrejtja. Shumica e incidenteve janë regjistruar pasi për to kanë informuar mediat apo Minsitria e Punëve të Brendshme, ndërsa 3 incidente janë paraqitur nga mbikëqyrësit e KHM-së. 35 incidente janë verifikuar nëpërmjet kontaktit me policinë, buletinet e policisë, informacionet në media dhe takimet me viktimat. 35 incidente nuk janë verifikuar, por, megjithatë, janë përfshirë në këtë raport sepse ekzistojnë indikatorë të anësisë, ku përfshihen: perceptimi i viktimës / dëshmitarit; komente të dhëna në vendngjarje, dallime midis viktimës dhe kryerësit në bazë etnike; modeli / dendësia e incidenteve të mëparshme; mënyra e dhunës; mungesa e motivit; lokacioni dhe koha.

Më konkretisht, incidentet e paverifikuara janë përfshirë për shkak të marrjes së informacionit për vendin e incidentit (p.sh. në lagje dhe shkolla të përziera etnikisht, linja të autobusëve që shfrytëzohen nga përfaqësues të bashkësive të ndryshme etnike, vende ku në të kaluarën kanë ndodhur krime nga urrejtja etj.), lloji i incidentit (p.sh. grup më i madh të miturish kanë sulmuar një viktimë pa qenë



1) Gjendet në: <http://hatecrime.osce.org/former-yugoslav-republic-macedonia> (shih ODIHR key observations).

2) Komisioni Evropian, 2016 Progress report for the former Yugoslav Republic of Macedonia, Brussels, 9 November 2015, faq. 61.

3) Gjendet në: <http://www.mhc.org.mk/analysis/209>

4) Gjendet në: <http://www.zlostorstvaodomraza.mk/page/index/2>

të provokuar, zënka në grupe, sulme në autobus apo në stacion të autobusëve etj.), koha e incidentit (pas një zënke të mëparshme si hakmarrje, pas përfundimit të orëve të mësimit në shkollë, gjatë një evenimenti sportiv apo pas përfundimit të tij etj.) dhe dëmtimi i pronës gjatë incidentit (p.sh. në vende për mbajtjen e ritualeve fetare).

Paraqitjet e paverifikuara dhe të verifikuara mund të shihen në ueb-faqen për informim mbi krimet nga urrejtja (ato të verifikuarat janë shënuar me tekst në një dritare të gjelbër, ndërsa të paverifikuarat me tekst në një dritare të kuqe). Në Aneksin I-rë të këtij raporti, incidentet e paverifikuara dhe të verifikuara janë theksuar me shënim në kllapa, menjëherë pas titullit të incidentit.


Në krahasim me krimet nga urrejtja të regjistruara në vitin 2015, ka rritje prej 60 % në numrin e incidenteve, në krahasim me vitin 2016 (44/70). Dallimi më i madh lidhet me përcaktimin apo bindjen politike, si motive të anësisë gjatë kryerjes së krimeve nga urrejtja. Rritja e këtij lloji krimi nga urrejtja nga viti 2015 deri në vitin 2016 është 320% (5/21). Në krahasim me incidentet e regjistruara në vitin 2013 dhe 2014, dallimi më i madh në 2015 dhe 2016 është në raport me viktimat, shumica e të cilave janë emigrantë dhe refugjatë. Në fund të vitit 2014 dhe gjatë vitit 2015 dhe 2016, shteti është dëshmitar për një numër të paparë të emigrantëve që kalojnë nëpër shtet në përpjekje që të hyjnë në Zonën e Shengenit në BE. 11 prej 70 incidenteve në vitin 2016 përmbajnë sulm dhe grabitje të emigrantëve dhe refugjatëve gjatë kalimit të tyre nëpër shtet. Në suazat e këtyre incidenteve, minimum 31 (pothuajse 35% e të gjitha viktimave të regjistruara) shtetas sirianë, afganistanas, irakianë dhe marokenë kanë qenë viktimat të krimit nga urrejtja.

Një dallim drastik midis viti 2013 dhe 2014, në krahasim me vitin 2015 dhe 2016 është edhe fakti se në vitin 2015 dhe 2016 nuk është regjistruar asnjë incident i krimit nga urrejtja për shkak të orientimit seksual / identitetit gjinor të viktimës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se shoqëria është bërë më tolerante ndaj bashkësisë LGBT. Këtu duhet të shtohet se pushtetet shtetërore kanë dështuar në gjetjen konkrete të incidenteve në vitin 2013 dhe 2014, ndërsa policia nuk ka arritur të arrestojë një numër të madh kryerësish. Mossuksesi i shtetit në mbrojtjen e viktimave, refuzimi i Parlamentit që ta përfshijë orientimin seksual si bazë për diskriminim të mundshëm dhe krime nga urrejtja, si dhe planet e Qeverisë që martesën ta përcaktojë me Kushtetutë si bashkësi vetëm midis burrit dhe gruas, kanë efekt negativ mbi individët e bashkësisë LGBT, të cilët ndoshta kanë frikë të paraqesin krimet e kryera mbi to.

Dallimi i fundit është numri i incidenteve për shkak të përkatësisë etnike maqedonase dhe shqiptare të kryerësit - viktimës. Në vitin 2013, këto incidente kanë qenë 84% prej incidenteve të përgjithshme (98 prej 116), ndërsa në vitin 2014, përqindja ka qenë 61% (53 prej 87). Në vitin 2015, kanë ndodhur vetëm 34% e incidenteve të tilla (15 nga 44). Gjatë vitit 2016, 34 incidente (prej 50%) kanë ndodhur midis maqedonasve dhe shqiptarëve. Trendi i zvogëlimit nga viti 2013 deri në vitin 2015 ka ndryshuar në vitin 2016. Edhe pse më të rralla sesa në vitin 2013 dhe 2014, këto incidente janë më shqetësuese në vitin 2016, siç ishte rasti edhe në të kaluarën,

3.3 Lloje të veprave penale



Pjesa më e madhe e krimeve janë kryer nga të rinjtë, vandalët dhe grabitësit. Viktimat dhe kryerësit më shpesh janë përfaqësues të bashkësive të ndryshme etnike (maqedonase ose shqiptare), ndërsa shumica e viktimave janë me prejardhje marokene, siriane, irakene dhe afganistanase. In-




cidentet e regjistruara lidhen me veprat penale të parapara në Kodin Penal të shtetit. Pjesa më e madhe e veprave penale përfshijnë: lëndim trupor, duke përfshirë edhe lëndime të rënda trupore (32), dhunë (29), dëmtim të pronës (28), rrezikim i sigurisë (27), pjesëmarrje në zënkë (10) dhe grabitje, duke përfshirë edhe vjedhje me armë (9). Mandej, 24 % të incidenteve futen në grupin e nxitjes së urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës në bazë kombëtare, racore, fetare apo bazë tjetër diskriminuese, ndërsa 1 eveniment

futet në diskriminim racor. Shpeshherë veprat penale që janë kryer në një incident plotësojnë kriteret për dy apo më tepër vepra penale, prej këtu rrjedh edhe numri më i madh i veprave penale, sesa incidentet e prezantuara në këtë kapitull.

3.4 Incidente sipas lokacionit




43 e incidente (70%) kanë ndodhur në Shkup dhe në rajonin urban të Shkupit. Ka pasur 8 incidente në Kumanovë, 4 në Manastir dhe Tetovë, 3 në Demir Kapi dhe Negotinë, 2 në Kavadar dhe 1 në Gostivar, Shtip dhe Koçan (në vetë qytetet apo në rajonet e qyteteve).



Shumë prej qyteteve ku kanë ndodhur incidentet gjenden përgjatë korridorit panevropian X. Incidentet kanë ndodhur në afërsi të autostradës ku kanë lëvizur refugjatët në rrugën e tyre drejt BE-së.

Në Shkup, incidentet përfshijnë sulme midis përfaqësuesve të bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare dhe dëmtim të pronës së partive politike. Incidentet e tilla janë rregjistruar në komunitet: Çair (8), Gjorçe Petrov (7), Karposh (6), Kisella Voda (4), Qendër dhe Butel (3), Haraçinë (2), Aerodrom, Çuçer Sandevo dhe Saraj (1).


3.5 Incidente sipas muajit



Nëntori është muaji kur kanë ndodhur numri më i madh i incidenteve - 18 (26% e të gjitha incidenteve të ndodhura gjatë tërë vitit). Ka pasur 12 incidente në shkurt dhe 10 në mars. Në tetor është regjistruar vetëm një incident. Gjithashtu edhe në qershor, gusht dhe shtator është regjistruar vetëm nga 1 incident. Shkaku për zmadhimin e menjëhershëm të incidenteve në shkurt, mars dhe nëntor qëndron në krizën politike e shoqëruar me nivel të tejkuluar të gjuhës së urrejtjes, si dhe zgjedhjet e parakohshme të përcaktuara dhe të shtyra mandej (për prill, kurse mandej për qershor) për vitin 2016, që më në fund u mbajtën në dhjetor.


3.6 Incidente nga motivimi i njëanshëm

Krime nga urrejtja kanë ndodhur për shkak të përkatësisë etnike (46%), përcaktimit politik (33%), statusit të viktimës refugjat, ose emigrant (16%), përkatësisë fetare (4%) dhe racizmit (1%). Pothuajse të gjitha incidentet përfshijnë maqedonas apo shqiptarë etnikë edhe si viktima edhe si kryerës, dhe refugjatët dhe emigrantët si viktimat.




3.7 Viktimat dhe autorët e krimit

Ka pasur minimum 92 viktima dhe 212 kryerës të krimeve nga urrejtja gjatë vitit. Gjithmonë kur mediat informonin për një numër të pacaktuar të kryerësve (për shembull midis 10 dhe 15), për këtë raport është marrë vlera më e vogël. Gjithmonë kur është informuar se një "grup" kryerësish kanë kryer krim prej urrejtjes, vlera që përdorej për këtë raport ishte 3 persona. Shumica e viktimave janë të mitur të gjinës mashkullore dhe refugjatë ose emigrantë. Më së paku 26 prej viktimave janë të mitur, kurse 31 prej tyre kanë qenë emigrantë, ndërsa numri më i madh i emigrantëve kanë qenë me prejardhje marokene (15). Më së paku 28 prej kryerësve kanë qenë të mitur.



3.8 Statusi i rasteve

Për çdo incident të ndodhur, KHM-ja ka dërguar kërkesë për informacion në Ministrinë e Punëve të Brendshme që të informohet për statusin e rastit. Kërkesat e fundit, duke përfshirë edhe kërkesat



për vijimin e procedurës janë dërguar në janar të vitit 2017, dhe janë pranuar gjatë shkurtit dhe marsit të vitit 2017. Deri në përfundimin e këtij raporti, Ministria ka siguruar informacione për 65 nga 70 incidentet. Policia i ka locuar kryerësit e dyshuar në lidhje me 18 prej 70 rasteve për të cilat ka siguruar informacione. Minimum 29 incidente të tjera janë paraqitur në polici dhe janë në hetim. Policia, gjithashtu, informon se nuk janë regjistruar dhe nuk kanë qenë të vetëdijshëm për 8 nga

incidentet e regjistruara prej KHM-së. Janë dorëzuar padi penale kundër kryerësve të 13 incidenteve, nga të cilat 2 kundër kryerësve të panjohur. Padi kundërvajtëse janë ngritur kundër kryerësve të 7 incidenteve.

4. AKTIVITETET E

EKIPIT TË PROJEKTIT

4.1 Monitorimi i mediave nacionale elektronike dhe të shtypura

KHM-ja ka ndjekur një numër të madh gazetash me përkatësi të ndryshme ideologjike dhe bindje të ndryshme politike. Monitorimi i mediave elektronike është bërë në bazë ditore, nëpërmjet dy gjeneratorëve më të njohur në internet të lajmeve (www.time.mk dhe www.daily.mk), si dhe duke përdorur opsionet e përparuara për kërkim në seksionin “Lajme” në www.google.com. Me të vërejtur krim apo incident nga urrejtja, KHM-ja i ka shpallur në faqen e internetit për paraqitje të krimeve nga urrejtja – www.zlostorstvaodomraza.mk (shiko Aktivitetin 4.4. më poshtë). Duke e zbatuar këtë aktivitet KHM-ja ka vënë re dhe ka shpallur 70 krime / incidente nga urrejtja në periudhën midis 1 janarit dhe 31 dhjetorit 2016.

4.2 Sigurimi i ndihmës juridike pa pagesë për viktimat e krimeve nga urrejtja dhe ndjekja e seancave gjyqësore

Për dallim nga viti 2013 dhe 2014, kur KHM-ja është kontaktuar edhe nga viktimat e krimeve nga urrejtja dhe kishte mundësi të regjistrojë një numër të madh viktimash nëpërmjet medieve të cilat shpallnin incidente të tilla, në vitin 2016 nuk kishte një mundësi të tillë. Ekzistojnë arsye të shumta për zvogëlimin e numrit të viktimave të cilat kanë marrë ndihmë juridike pa pagesë në vitin 2015, për dallim nga viti 2013-2014: 1) numri i zvogëluar i incidenteve; 2) numri i madh i kryerësve të panjohur; 3) numri më i vogël i viktimave që i janë drejtuar KHM-së; 4) viktimat të cilat janë refugjatë dhe emigrantë e kanë lëshuar vendin menjëherë pas incidentit; 5) viktimat nuk u janë drejtuar mediave; 6) hulumtimi i KHM-së në vitin 2015 dëshmoi se po mbahet vetëm një rast i kimit nga urrejtja nëpër të gjitha gjykatat në vendet.

Është siguruar ndihmë juridike për 11 refugjatë dhe emigrantë nga Siria dhe Maroku. Incidenti i parë ka ndodhur më 15 janar 2016 në afërsi të fshatit Reçicë, Kumanovë (shiko incidentin nr. 6 në Aneksin I). Në rrugën drejt Qendrës lokale pranuese për emigrantë në Tabanovcë, Kumanovë, mbikëqyrës lokal i KHM-së (duke punuar në një projekt tjetër me qëllim ndjekjen e gjendjes me krizën e emigrantëve), ka hasur 8 emigrantë me prejardhje nga Maroku të cilëve më parë u janë kërcënuar me pistoletë, janë sulmuar me thikë dhe janë grabitur nga një grup prej tre kryerësish të panjohur. Mbikëqyrësi lokal i ka shoqëruar viktimat deri në stacionin policor në Kumanovë ku e kanë paraqitur rastin me të gjitha të dhënat e njohura për rastin. Në mars të vitit 2016 hetimi policor ka qenë në vijim, kurse kryerësit kanë qenë ende të lirë.

Incidenti i dytë ka ndodhur më 26 prill 2016, ku viktimë ka qenë një emigrant nga Siria i cili është sulmuar gjatë rrugës për në Qendrën pranuese për emigrantë në Tabanovcë deri në fshatin Vaksincë (shiko incidentin nr. 32 në Aneksin I). Emigranti është sulmuar dhe grabitur nga një grup i panjohur

kryerësish, pastaj është kthyer në Qendrën në Tabanovcë. Pasi ka hyrë në qendër i është drejtuar mbikëqyrësit lokal të KHM-së që ka qenë në atë turn në qendër i cili e ka çuar te nëpunësit policorë në Qendër ku krimi është paraqitur dhe regjistruar. Në maj të vitit 2016, hetimi policor ishte në vijim, kurse kryerësit ishin ende në liri. Sipas Stacionit policor Kumanovë, rasti është hetuar, por megjithatë në përgjigjen e MPB-së, pas kërkesës së Komitetit, thuhet se nuk është paraqitur një incident i tillë.

Incidenti i tretë ka ndodhur më 12 gusht 2016 dhe ka përfshirë dy emigrantë nga Siria përgjatë rrugës nga fshati Vaksincë deri në Qendrën pranuese për emigrantë në Tabanovcë (shiko incidentin nr. 42 në Aneksin I). Dhe të dy janë sulmuar nga pesë kryerës të panjohur, kurse njërit i është shkaktuar lëndim me thikë. Pasi kanë hyrë në qendër, emigrantët i janë drejtuar Kryqit të Kuq dhe mbikëqyrësit lokal të KHM-së që ka qenë në turn, i cili i ka dërguar te nëpunësit policorë në Qendër të cilët e kanë regjistruar krimin.

Kur bëhet fjalë për ndjekjen e seancave gjyqësore, në maj 2015, KHM-ja ka marrë përgjigje për kërkesat e veta për informacione nga të gjitha 26 gjykatat themelore të shtetit për gjykimet në vijim lidhur me krimet nga urrejtja.⁵ Në vijim ishte vetëm një gjykim i krimit nga urrejtja (shkaktim i urrejtjes nacionale, racore apo fetare, përçarjes apo mostolerancës) në Gjykatën Themelore Strugë, regjistruar nga KHM-ja në gusht të vitit 2013. Gjykimi ka të bëjë me një të akuzuar, anëtar i bashkësisë fetare islame, që është akuzuar për shkak të veprimeve të tij jolegale në lidhje me pengimin e banorëve lokal gjatë ndërtimit të kishës.⁶ Me gjasë, i akuzuari e ka ndaluar gjykatësin i cili ka qenë në vendngjarje duke kryer mbikëqyrje gjyqësore në lidhje me Kishën ortodokse “Shën. Atanasi” kundër Komunë së Strugës. I akuzuari i është drejtuar me zë të lartë grupit të qytetarëve të mbledhur, duke u thënë se fshatarët i përkasin besimit islam, kështu që nuk ka vend për të krishterët, kinse ka shkaktuar ndjenjë të urrejtjes fetare midis dëshmitarëve dhe të pranishmëve të tjerë. Në mars të vitit 2017, KHM ka marrë përgjigje për kërkesën për informacione - aktvendimin përfundimtar - nga Gjykata Themelore në Strugë. I akuzuari është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënim me kusht prej një viti burg. Dënimi nuk do të zbatohet nëse i akuzuari nuk kryen edhe një vepër penale në dy vitet në vijim.

4.3 Informimi i OSBE / ODIHR-it mbi incidentet dhe krimet nga urrejtja

Nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2016, KHM-ja regjistroi 70 incidente / krime nga urrejtja. 25 prej tyre janë verifikuar, ndërsa 35 ende nuk janë verifikuar. Incidente si pasojë e përkatësisë etnike (34 incidente), përkatësisë apo bindjes politike (21 incidente) dhe statusi i emigrantit apo refugjatit (11 incidente) janë arsyet më të shpeshta për kryerjen e krimeve nga urrejtja në vitin 2016. Pastaj, 3 incidente kanë ndodhur për shkak të përkatësisë apo bindjes fetare, kurse 1 incident ka qenë rezultat i diskriminimit racor. 1 prej incidenteve ka ndodhur gjatë një gare sportive, ndërsa 24 prej incidenteve i përmbushin kriteret për veprën penale “shkaktim i urrejtjes nacionale, racore apo fetare, përçarjes dhe jo-tolerancës”. Viktimat dhe kryerësit më shpesh janë me prejardhje të ndryshme etnike (maqedonase, shqiptare, marokene dhe siriane) ose mbështetës të të dyja partive më të mëdha politike në shtet (LSDM dhe VMRO-DPMNE) ose të partnerëve të tyre të koalicionit.

Detaje rreth incidenteve, si edhe një përshkrim i shkurtër, data, koha dhe vendi, burimi i informatave, viktimat e përfshira, kryerësit, statusi i rastit, përgjigja e pushtetit, ndikimi mbi viktimat dhe mjedisin vendor mund të gjenden në Aneksin I të këtij raporti, me titull “Incidente të krimeve nga ur-

5) Raporti vjetor i krimeve nga krimet e urrejtjes në vitin 2015, f. 105. Gjetet në: <http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactorassets/documents/2017/ZLOSTORSTVAODOMRAZA2015EN.pdf>

6) Për më shumë detaje shih, Raportin vjetor të krimeve nga urrejtja në vitin 2013, Aneks I, Incidenti nr. 59, faq. 49: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/692/HATE_CRIMES_MACEDONIA_-_ANNUAL_REPORT_2013.pdf

rejtja në vitin 2016”. Në të njëjtin aneks ka edhe një fushë “indikatore të anësisë” e cila përfshihet në çdo incident të veçantë. Ajo përmban të dhëna, si: Perceptimi i viktimës / dëshmitarit; Komente për vendin e ngjarjes; Dallimi midis viktimës dhe kryerësit në bazë etnike; Modeli / dendësia e kryerjes së incidenteve të mëparshme; Natyra e dhunës; Mungesa e motiveve të tjera; Koha dhe vendi. Përveç se mundëson informacione shtesë në lidhje me incidentet, kjo pjesë është e dobishme që të kuptohet pse një incident i paverifikuar është përfshirë në këtë raport.

Në prill të vitit 2016, KHM-ja e ka dërguar Raportin e vet për krime nga urrejtja për vitin 2015 tek ODIHR. Në nëntor të vitit 2016, ODIHR shpalli rezyme të 34 incidenteve të paraqitura dhe i ka vendosur në ueb-faqen për Paraqitje të krimeve nga urrejtja.⁷ KHM mbetet organizata e vetme e cila e informon ODIHR-in mbi gjendjen me krimet nga urrejtja në shtet.

4.4 Mirëmbajtja e ueb-faqes interaktive për paraqitje të krimeve nga urrejtja

Ueb-faqja www.zlostorstvaodomraza.com (ndërsa prej vitit 2014, qasje ka edhe në www.zlostorstvaodomraza.mk) është mjet interaktiv i cili u mundëson qytetarëve të marrin informacione dhe të paraqesin krime nga urrejtja. Faqja përmban hartë interaktive ku janë treguar lokacionet e sakta apo të përafërta të incidenteve. Në faqen kryesore ka një listë të kategorive të krimeve nga urrejtja dhe motivimet që mbajnë anë, ajo siguron informata me mënyrën se si qytetarët mund të paraqesin (e-aplikacion, twitter, postë elektronike dhe formular elektronik) dhe në të janë pasqyruar grafikë statistikorë. Gjithashtu ka edhe PPSH, materiale dhe fjalor ku mund të gjenden informata në lidhje me projektin, rëndësinë dhe spektrin e krimeve nga urrejtja, si dhe publikime për krime nga urrejtja. Periodikisht janë azhurnuar edhe profilet në Facebook dhe Twitter.

Gjatë periudhës së raportimit në ueb-faqe janë vendosur 70 incidente, 24 fotografi dhe 2 video. Raporti vjetor për krime nga urrejtja për vitin 2015 është vendosur në portal në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze në kategorinë “Resurse”. Të gjitha incidentet që janë regjistruar në vitin 2015 janë përkthyer në shqip dhe anglisht dhe tani gjenden në portal edhe në këto gjuhë.

4.5 Kontributi në 8 punëtori për trajnim të policisë

Të gjitha punëtoritë u mbajtën në 8 rajonet gjeografike të vendit gjatë periudhës së informimit për projektin. Anëtarët e ekipit të projektit Voislav Stojanovski dhe Pavle Bogoevski dhanë kontribut duke prezantuar qasjet kryesore të projektit prej vitit 2013 deri në vitin 2016 dhe biseduan për incidentet e krimeve nga urrejtja me nëpunësit policorë me gradë të lartë

4.6 Shënimi i 22 Korrikut - Dita Evropiane e Viktimave nga Krimet e Urrejtjes

KHM-ja e shënoi 22 Korrikun – Ditën Evropiane të Viktimave nga Krimet e Urrejtjes, duke organizuar dy evenimente të caktuara. Evenimenti i parë përbëhej nga Konferenca për mediet, ndërsa evenimenti i dytë u mbajt në Parkun e Qytetit në Shkup. Ky eveniment u organizua për të tretën herë radhazi, pas evenimentit të parë në vitin 2014 dhe është titulluar “Turli tava 3 – Së bashku është më e shijshme”. Evenimenti përfshinte fjalime, muzikë dhe shoqërim midis pjesëmarrësve me prejardhje të ndryshme etnike, gjatë degustimit të ushqimit tradicional maqedonas, shqiptar, turk, rom, serb, boshnjak dhe vllëh (siç është edhe turli tava - ushqim tradicional ballkanas). Përfaqësuesit e shumë medie morën pjesë edhe në konferencën për shtypin edhe në evenimentin kulturor dhe informuan për mesazhin e tolerancës të cilin e dërguan pjesëmarrësit

⁷ <http://hatecrime.osce.org/former-yugoslav-republic-macedonia>

5. KONKLUZIONE

- Ekziston rritje prej 60% e numrit të incidenteve në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.
- Shteti ka bërë hapat e parë për mbledhjen e të dhënave mbi veprat e urrejtjes, edhe pse të dhënat e mbledhura nuk janë në dispozicion të publikut dhe nuk është e qartë se a e kuptojnë pushtetet dallimin midis gjuhës së urrejtjes dhe krimeve nga urrejtja.
- Emigrantët dhe refugjatët që kalojnë nëpër territorin e vendit janë të ekspozuar ndaj rrezikut të madh që të bëhen viktimat të krimeve nga urrejtja.
- Pas rënies së numrit të incidenteve midis anëtarëve të bashkësisë maqedonase dhe shqiptare në vitin 2015, numri i incidenteve të tilla në vitin 2016 është përsëri në rritje.
- Disa viktimat nga urrejtja janë kryer si hakmarrje apo si dënim për incidentet e mëparshme nga të rinjtë maqedonas dhe shqiptarë.
- Më tepër incidente kanë ndodhur në Qytetin e Shkupit, por gjithashtu edhe përgjatë korridorit panevropian X, në afërsi të autostradës nëpër të cilën lëvizin emigrantët dhe refugjatët për në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian.
- Partitë politike përdorin shpesh gjuhë të urrejtjes në debatet publike dhe gjatë fushatave parazgjedhore që çon në kryerjen e krimeve nga urrejtja prej mbështetësve të tyre.
- Krimet e motivuara nga anësia nuk paraqiten dhe hetohen akoma ashtu siç duhet nga policia.
- Bëhen shumë pak përpjekje për masat parandaluese, duke përfshirë edhe edukimin mbi të drejtat e njeriut dhe ngritjen e vetëdijes publike.
- Meqenëse fenomeni i krimeve nga urrejtja nuk trajtohet si problem i veçantë, shteti nuk u ofron mbrojtje dhe mbështetje të veçantë viktimave.
- Viktimat nuk dëshirojnë të përmendet emri i tyre, nuk duan publicitet, dhe nuk ju drejtohen institucioneve shtetërore, sepse kanë frikë nga reperkusionet, si rrjedhojë kemi paraqitje të vogël të rasteve dhe mungesë të besimit publik te sistemi.
- Viktimat më të prekura në shtet janë të miturit, si dhe refugjatët të cilët kalojnë nëpër shtet në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian

6. REKOMANDIME

Gjatë takimit të Këshillit të BE-së për drejtësi dhe punë të brendshme, të mbajtur në Bruksel më 5 dhe 6 dhjetor 2013, Këshilli i shpalli konkluzionet për luftën kundër krimeve nga urrejtja në BE.⁸ Si shtet kandidat për anëtarësim në BE, shteti duhet t'i ndjekë rekomandimet e paraqitura në konkluzat të cilat, në përgjithësi, janë në përputhje me rekomandimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave në OSBE-së nr. 9/09: Lufta kundër krimeve nga urrejtja dhe qasja e KHM-së.

1. Të merret parasysh përvoja e shteteve anëtare të BE-së për zgjerim në suazat e legjislacionit të tyre penal, spektri i veprave të dënueshme për krime nga urrejtja dhe përfshirja e motiveve të tjera për anësi për këto vepra.

2. Të sigurohet hetim dhe ndjekje efikase, dhe në kohë i krimeve nga urrejtja, duke pasur parasysh motivet për anësi gjatë gjithë procedurës penale.

3. Të merren masat adekuate që të lehtësohet paraqitja e krimeve nga urrejtja e viktimave dhe gjithashtu, të përforcohen sa më shumë që mundet shoqatat për mbështetjen e tyre, duke përfshirë edhe masat për ndërtimin e besimit të policia dhe tek institucionet e tjera shtetërore.

4. Të mblidhen dhe të shpallen të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme për krime nga urrejtja, sa më shumë, duke përfshirë edhe incidentet e tilla të paraqitura nga policia dhe të regjistruara nga organet e ndjekës, numri i aktvendimeve, motivet për anshmëri për këto krime, si dhe dënimet e shqiptuara ndaj shkelësve.

5. Të sigurohet se viktimave të krimeve nga urrejtja u është dhënë ndihmë, mbështetje dhe mbrojtje.

6. Të promovohen trajnime për praktikuesit relevantë të cilët hyjnë në kontakt me viktimat e krimeve nga urrejtja, kështu që do t'u mundësojnë t'i ndihmojnë viktimat.

7. Të përmirësohen masat parandaluese, midis të tjerash, duke reflektuar mbi kujtimet gjatë edukimit për të drejtat e njeriut, programet mësimore të historisë dhe trajnime përkatëse, duke ndërmarrë hapa për edukim të publikut mbi vlerat e dallimeve kulturore dhe përfshirjes, dhe duke synuar që të gjitha pjesët e shoqërisë të kenë rol në luftën kundër jo-tolerancës së tillë.

8) Gjendet në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/jha/139949.pdf

ANEKS I

INCIDENTE DHE KRIME NGA URREJTJA NË VITIN 2016

1. Marokenë janë grabitur në Demir Kapi (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy emigrantë nga Maroku janë grabitur në afërsi të Demir Kapisë nga tri persona të panjohur të cilët i kanë takuar dhe u janë kërcënuar se do t'i vrasin, kurse më pas u kanë marrë 1.750 euro dhe një telefon celular.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 6 janar, rreth orës 13.30, në afërsi të Demir Kapisë.

Burimi i informacioneve: Gazeta ditore "Utrinski vesnik".

Viktimat e përfshira: Dy marokenë.

Lloji i krimit: Grabitje (Neni 237, KP)

Kryerës: 3 kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* – prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme; viktimat janë përfaqësues të grupit (emigrantë marokenë) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti;

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nuk është regjistruar një veprë e tillë penale në rajonin e SPB-së Veles.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër vend.

2. Sulmohet një grup emigrantësh nga Maroku (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Tre shtetas të Marokut janë grabitur në afërsi të Demir Kapisë nga tre persona të panjohur të cilët u janë kërcënuar dhe u kanë marrë 900 euro.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 6 janar, rreth orës 20, në afërsi të Demir Kapisë.

Burimi i informacioneve: Medie elektronike MKD.mk

Viktimat e përfshira: Tre marokenë.

Lloji i krimit: Grabitje (Neni 237, KP), Vjedhje e rëndë (Neni 236, KP)

Kryerës: 3 kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme; viktimat janë përfaqësues të grupit (emigrantë marokenë) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe

sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nuk është regjistruar një vepër e tillë penale në rajonin e SPB-së Veles.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër vend.

3. Marokenë të rrahur me shkop bejsbolli dhe goditje elektrike (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në afërsi të Shkupit, te stacioni hekurudhor jashtë qytetit, dy emigrantë shtetas të Marokut, janë keqtrajtuar nga tri persona të panjohur me shkop bejsbolli dhe goditje elektrike, më pas u kanë marrë nga 300 euro, dokumentet e telefonit dhe një telefon celular “Sony”.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 7 janar, ora 13:15, në stacion hekurudhor në afërsi të Shkupit.

Burimi i informacioneve: Medie elektronike MKD.mk.

Viktimat e përfshira: Dy marokenë.

Lloji i krimit: Grabitje (Neni 237, KP), Dhunë (Neni 386, KP) Vjedhje e rëndë (Neni 236, KP).

Kryerës: 3 kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme; viktimat janë përfaqësues të grupit (emigrantë marokenë) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti;

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes është informuar prokurori publik nga PTHP Kumanovë dhe është përgatitur procesverbal për pranim të fletëparaqitjes i cili me anë të postës zyrtare është dërguar në SPB Shkup për veprim të mëtejshëm.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër vend.

4. Marokenë janë sulmuar në afërsi të Kumanovës (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy emigrantë, shtetas marokenë, të cilët një ditë më parë janë sulmuar në afërsi të Shkupit, janë sulmuar përsëri fizikisht në afërsi të Kumanovës, dhe kjo nga dy persona të cilët i kanë transportuar me PMV, ndërkohë njëri prej tyre arriti të ikë dhe është fshehur, kurse tjetrit me grushta i janë shkaktuar lëndime të dukshme trupore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 8 janar, ora 23:50, në afërsi të Kumanovës.

Burimi i informacioneve: Medie elektronike Kumanovski muabeti.

Viktimat e përfshira: Dy marokenë.

Lloji i krimit: Lëndime trupore (Neni 130, KP)

Kryerës: 2 kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme; vikti-

mat janë përfaqësues të grupit (emigrantë marokenë) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti;

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes është informuar Prokurori Publik nga PTHP Kumanovë dhe është përgatitur procesverbal për pranim të fletëparaqitjes i cili me anë të postës zyrtare është dërguar në SPB Kumanovë për veprim të mëtejshëm.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër vend.

5. Përpjekja që t'i vihet zjarri kishës në Saraj (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një person i panjohur me përdorim të sulcionit ndezës ka shkakuar zjarr në kishën "Shën. Zllata Meglenska" në Saraj të Shkupit, duke e djegur dhe shkatërruar kështu derën hyrëse të kishës.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 14 janar, rreth orës dy pas mesnatës, në Saraj të Shkupit.

Burimi i informacioneve: Gazeta ditore "Dnevnik".

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore dhe fetare (Neni 319, KP).

Kryerës: Kryerës i panjohur.

Përshtkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia apo bindja fetare, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Vendndodhja e incidentit - kisha e krishterë ortodokse në një mjedis dominues shqiptar.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga SPB Shkup është dorëzuar procesverbal për mbikëqyrjen e kryer në Procedurën Themelore Publike Shkup.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e bashkësive të ndryshme fetare në shtet.

6. Emigrantë nga Maroku janë sulmuar dhe grabitur në afërsi të fshatit Reçicë, Kumanovë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: 8 emigrantë ekonomikë nga Maroku janë sulmuar nga një grup prej tre personash të cilët kanë dalë nga një automobil BMW X5 me ngjyrë argjendi. Njëri prej grupit të sulmuesve posedonte pistoletë, kurse të tjerët thika.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 15 janar, rreth orës 00:15, në afërsi të pompës së benzinës "Detoil" në afërsi të fshatit Reçicë, Kumanovë.

Burimi i informacioneve: Mbikëqyrës i Komitetit të Helsinkit.

Viktimat e përfshira: 8 marokenë.

Lloji i krimit: Grabitje (Neni 237, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP) Vjedhje e rëndë (Neni 236, KP).

Kryerës: 3 kryerës të panjohur.

Përshtkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është

prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme; viktimat janë përfaqësues të grupit (emigrantë marokenë) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti;

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se në SPB Kumanovë nuk është pranuar fletëparaqitje për këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër vend.

7. Me thikë janë dëmtuar ikonat dhe afresket e kishës në Haraçinë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës të panjohur kanë vizatuar organe seksuale dhe me thikë i kanë dëmtuar afresket dhe ikonat në kishën e vetme ortodokse “Shën. Talalej” në fshatin Haraçinë të Shkupit, ndërsa më pas e kanë demoluar brenda edhe kishën.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 27 janar, koha e panjohur, Haraçinë e Shkupit.

Burimi i informacioneve: Medie elektronike MKD.mk.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore dhe fetare (Neni 319, KP).

Kryerës: Një grup kryerësish të panjohur.

Përshtkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia apo bindja fetare, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Vendndodhja e incidentit - kisha e krishterë ortodokse në një mjedis dominues shqiptar.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - pas konfliktit të vitit 2001 kisha është viktimë e rregullt e kryerësve të ndryshëm të cilët e kanë demoluar kuzhinën e kishës, si dhe pllakat e varreve të të varrosurve të bashkësisë maqedonase.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se në SPB Shkup nuk është paraqitur një ngjarje e tillë.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e bashkësive të ndryshme fetare në shtet.

8. Grabitje e një emigranti nga Iraku (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në afërsi të stacionit hekurudhor në Demir Kapi, një grup kryerësish të panjohur kanë kryer grabitje të një refugjati nga Iraku. Pasi kanë parë që refugjati po fle, kanë filluar ta godasin me grushte dhe shqelma nëpër trup dhe kokë, kurse më pas i kanë marrë një telefon celular dhe 50 euro.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 29 janar, rreth orës 23, në afërsi të stacionit hekurudhor në Demir Kapi.

Burim i informacioneve: Medie elektronike Plusinfo.

Viktimat e përfshira: Një irakian.

Lloji i krimit: Grabitje (Neni 237, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerës: Një grup kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme; viktimat janë përfaqësues të grupit (emigrant irakian) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti;

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale kundërgjashtë personave për veprën penale - Grabitje.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga SPB-ja Veles janë ndërmarrë masat dhe aktivitetet dhe pas dokumentimit të tërësishëm të ngjarjes, në Prokurorinë Themelore Publike Veles është dorëzuar fletëparaqitje penale kundërgjashtë personave, sepse ekziston dyshim se kanë kryer veprën penale - Grabitje, sipas nenit 237, paragrafi 1 i KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër vend.

9. Një djalosh nëntëmbëdhjetë vjeçar është goditur me një objekt të mprehtë në kraharor (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një djalosh nëntëmbëdhjetë vjeçar është goditur me objekt të mprehtë në kraharor dhe ije, duke zbritur nga autobusi me nr. 19 në stacionin e autobusit të kompleksi Treska, në Shkup. Djaloshi së bashku me dy shokë ka zbritur nga autobusi, kurse më pas nga i njëjti autobus kanë zbritur edhe katër persona dhe pa shkas dhe arsye e kanë goditur djaloshin në kraharor dhe ije. Në Qendrën e Urgjencës të djaloshi janë konstatuar lëndime të rënda trupore (është shpuar pleura e mushkërisë).

Data, koha dhe vendi i incidentit: 1 shkurt, rreth orës 21, stacioni i autobusit të kompleksi Treska, në Shkup.

Burim i informacioneve: Medie elektronike Makfaks

Viktimat e përfshira: Një djalosh nëntëmbëdhjetë vjeçar.

Lloji i krimit: Lëndim trupor (Neni 130, KP), Dhunë (Neni 386, KP), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP).

Kryerës: Grup prej 4 kryerësve të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - drejtpërdrejt para incidentit, kryerësit dhe viktimat kanë udhëtuar me autobus nr. 19 që qarkullon në rajonin e banuar me njerëz me përbërje të përzierë etnike;

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga SPB-ja Shkup është dorëzuar lajmërim me shkrim më 4.2.2016 të Prokuroria Publike Themelore Shkup.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

10. Grindje në grup në shkollën e mesme “Zef Lush Marku” (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy grupe nxënësish kanë marrë pjesë në grindje në oborrin e shkollës SHQSH “Zef Lush Marku”. Në një grup kanë qenë tre të mitur nga Shkupi dhe një i mitur nga Gostivari, kurse në

grupin tjetër kanë qenë katër të mitur nga fshati Batincë i Shkupit. Personat kanë shkëmbyer disa goditje me grushte dhe shqelma, kurse në një moment një preson nga grupi i dytë ka nxjerrë thikë dhe ka goditur katër herë në pjesën e kokës një nxënës të grupit të parë duke i shkaktuar lëndim trupor, dukshëm të rëndë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 9 shkurt, ora 09:45, oborri i shkollës SHQSH “Zef Lush Marku”.

Burim i informacioneve: Medie elektronike Republika.

Viktimat e përfshira: Një person.

Lloji i krimit: Lëndim trupor (Neni 130, KP), Dhunë (Neni 386, KP), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP).

Kryerës: Një grup nxënësish nga SHQSH “Zef Lush Marku”.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - për shkak të përbërjes së përzierë etnike të nxënësve të cilët mësojnë në shkollën e sipërpërmendur, ka mundësi që përfaqësuesit e të dy grupeve të kenë prejardhje të ndryshme etnike;

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është dorëzuar kërkesë për ngritjen e procedurës kontestuese.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga SPB-ja Shkup është dorëzuar lajmërim me shkrim për ngritje të procedurës për kundërvajtje më 19.4.2016 te Gjykata Themelore Shkup 1, Shkup, Njësia për Kundërvajtje.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

11. Një grup prej 10 anëtarësh ka grabitur tre emigrantë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një grup kryerësish të panjohur kanë kryer grabitje të tre shtetasve të Sri-Lankës në fshatin Vizbegovë në afërsi të Qendrës për Kërkues të Azilit. Ndërkohë që tre personat kanë lëvizur nëpër rrugë janë takuar nga 10 persona meshkuj, të veshur me veshje të errëta dhe maska në kokë, të cilët i kanë rrethuar dhe me kërcënim dhe përdorim të forcës fizike u kanë marrë dy telefona celularë, 120 euro dhe kartën identifikuese për azil, pastaj janë larguar nga vendngjarja. Kështu kryerësit kanë fituar dobi pronësore të paligjshme prej 51.000 denarësh.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 11 shkurt, ora 12:45, në afërsi të Qendrës për Kërkues të Azilit në fshatin Vizbegovë.

Burim i informacioneve: Medie elektronike MKD.

Viktimat e përfshira: Tre emigrantë nga Sri-Lanka.

Lloji i krimit: Grabitje (Neni 237, KP), Vjedhje e rëndë (Neni 236, KP)

Kryerës: Një grup prej 10 kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme; viktima është përfaqësues i grupit (emigrant nga Sri-Lanka) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti;

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga SPB-ja Shkup është dorëzuar

Lajmërim më 17.2.2016 Prokuroria Themelore Publike - Shkup.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

12. Janë sulmuar të mitur në autobus (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: një i mitur 17 vjeçar dhe dy shokë të tij 16 dhe 17 vjetësh janë sulmuar fizikisht nga më tepër persona në një autobus të NPQ nr. 65.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 12 shkurt, rreth orës 12:20, në autobus të NPQ-së, nr. 65, rr. "Anton Popov" në Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Reporter.

Viktimat e përfshira: Tre persona të mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP).

Kryerës: Një grup kryerësish të panjohurish.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - kryerësit dhe viktimat kanë udhëtuar me autobus nr. 65 që qarkullon në rajonin e banuar me njerëz me përbërje të përzierë etnike;

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është dërguar kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga SPB Shkup është dorëzuar kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse më 17.3.2016 në Gjykatën Themelore Shkup 1, Shkup, Sektori për kundërvajtje.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

13. Disa të mitur kanë sulmuar një djalosh në Tetovë (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Katër persona të mitur, të veshur me bluza të zeza me kapele, para ndërtesës në rrugën "Bllagoj Toska" në Tetovë kanë sulmuar një djalosh 16 vjeçar, të cilët me grushte ia kanë thyer hundën.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 12 shkurt, rreth orës 13, para ndërtesës në rrugën "Bllagoj Toska" në Tetovë.

Burim i informacioneve: Gazeta ditore "Vest".

Viktimat e përfshira: Një person i mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Grup prej 4 personash të mitur të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - incidenti ka ndodhur në qytet me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është ngritur kallëzim penal kundër kryerësve të panjohur në Prokurorinë Themelore Publike - Tetovë, për veprën penale "Lëndim i rëndë trupor".

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Tetovë është ngritur kallëzim penal kundër kryerësve të panjohur në Prokurorinë Themelore Publike - Tetovë, për veprën

penale “Lëndim i rëndë trupor”.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

14. Katër djem kanë sulmuar një bashkënxënës para SHM “Llazar Tanev” (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një nxënës i vitit të tretë në shkollën e mesme “Llazar Tanev” në Shkup është sulmuar nga bashkënxënësit e tij para hyrjes së gjimnazit. Nxënësi, pas incidentit, me ambulancën e urgjencës është dërguar në Qendrën Klinike, ku i është dhënë ndihma mjekësore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 17 shkurt, rreth orës 13:40, në shkollën e mesme “Llazar Tanev” në Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Reporter.

Viktimat e përfshira: Një person i mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Grup prej 4 personash, prej të cilëve 3 janë të mitur dhe një person është i moshës madhore.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - për shkak të përbërjes etnike të përzierë të nxënësve që shkojnë në shkollën e lartpërmendur, ka mundësi që prejardhja etnike e kryerësve të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është dorëzuar kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Shkup është dorëzuar kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse më 1.3.2016 në Gjykatën Themelore Shkup 1 - Shkup, Sektori për kundërvajtje.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

15. Janë sulmuar nxënës në SHMKSH “Dimitar Vllahov” në Shkup (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Persona të mitur - nxënës në SHMKSH “Dimitar Vllahov”, janë sulmuar disa herë fizikisht nga persona të panjohur te Qendra e Transportit në Shkup, në parkingun nën urën, te depoja e Shërbimit të karrotrecëve.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 20 shkurt, rreth orës 13:30, te parkingu nën urën, te depoja e Shërbimit të karrotrecëve, te Qendra e Transportit në Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Reporter.

Viktimat e përfshira: Disa persona të mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP)

Kryerës: Një grup prej disa personash të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - për shkak të përbërjes etnike të përzierë të nxënësve që shkojnë në shkollën e lartpërmendur, ka mundësi që prejardhja etnike e kryerësve të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është dorëzuar kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Shkup është dorëzuar kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse në Gjykatën Themelore Shkup 1 - Shkup, Sektori për kundërvajtje.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

16. Janë sulmuar disa të mitur në bregun e lumit (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një grup prej disa personash të mitur janë sulmuar fizikisht nga një grup prej pesë-gjashtë personash të tjetër në moshë prej rreth 20 vitesh.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 20 shkurt, rreth orës 22:00, në rr. “13 Nëntori”.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Republika.

Viktimat e përfshira: Një grup prej disa personash të mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP)

Kryerës: Grup prej disa personash në moshë prej njëzet vjetësh.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - gjatë viteve të kaluara, në afërsi të bregut të lumit dhe parkut të qytetit shpeshherë kanë ndodhur incidente etnikisht të motivuara.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Shkup është mbajtur procesverbal për praninë të fletëparaqitjes dhe ndërmerren masa për pastrim të kësaj shkeljeje.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

17. 13 të lënduar nga grindja midis grupeve të tifozëve “Tiranët” dhe “Ballistët” (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: 13 persona, prej të cilëve 11 shtetas malazezë dhe dy përfaqësues të bashkësisë maqedonase, janë lënduar në një grindje masive midis tifozëve të KF “Buduqnost” nga Podgorica dhe KF “Shkëndija” nga Tetova, që ka ndodhur te vendi i quajtur “Sretkovski most” para qafës së Strazhës. Sipas informacioneve të policisë, incidenti ka ndodhur pasi njëri prej autobusëve të cilët i kanë transportuar tifozët e Shkëndisë që shkonin në Kërçovë ndaloi në rrugë, kurse në anën tjetër të rrugës erdhën dy autobusë të cilët transportonin tifozë të KF “Buduqnost” për ndeshjen me Vardarin në Shkup. Tifozët e KF “Shkëndija” kanë filluar të gjuajnë me gurë autobusët të cilët ndaluan dhe prej tyre kanë dalë tifozët malazezë dhe më pas ka ndodhur rrahje masive ku janë përdorur gurë dhe objekte të tjera. Dy tifozë malazezë, për shkak të seriozitetit të incidentit, pasi u është dhënë ndihmë mjekësore janë dërguar në Qendrën e Urgjencës në Shkup, kurse nëntë tifozëve të tjerë malazezë të lënduar më lehtë, u është dhënë ndihmë mjekësore në spitalin e Gostivarit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 21 shkurt, ora 12:30, para qafës së Strazhës.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Sport Klub dhe Makfaks.

Viktimat e përfshira: 13 persona prej të cilëve dy të lënduar më rëndë dhe nëntë të tjerë të lënduar më lehtë, tifozë të Buduqnostit dhe dy tifozë të lënduar më lehtë të Shkëndijës.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP), Lëndim i rëndë trupor (Neni 131, KP) Lëndim trupor (Neni 130, KP), Shkaktim i urrejtjes, përçarjes apo mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare apo bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Një grup tifozësh të panjohurish të KF “Shkëndija”.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, i cili ka ndodhur gjatë një ngjarjeje sportive, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - anëtarë të klubeve të tifozëve (“Tiranët” dhe “Ballistët”) janë me prejardhje të ndryshme etnike;
2. *Koha* - Incidenti ka ndodhur pas ndeshjes së futbollit midis klubeve, tifozët / mbështetësit e të cilëve kanë prejardhje të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale kundër 14 personave për veprën penale Pjesëmarrje në rrahje.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas dokumentimit dhe ndriçimit të tërësishëm të ngjarjes penale juridike nga Zyra e Jashtme për Punë Kriminale në SP Gostivar, është dorëzuar fletëparaqitje penale më 22.2.2016 te Prokuroria Themelore Publike Gostivar, kundër 14 personave, prej të cilëve 11 shtetas të Malit të Zi dhe 3 persona shtetas të vendit për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar në kryerjen e veprës penale Pjesëmarrje në rrahje e paraparë në nenin 132 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Incidente të tilla e vënë në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në shtet, bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri dhe sigurinë e njerëzve të pranishëm, apo që janë në afërsi të ndeshjeve sportive.

18. Rrahje midis tifozëve të Vardarit dhe Buduqnost në QTQ (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një grup tifozësh të KF “Buduqnost” janë sulmuar nga një grup tifozësh të KF “Vardar” ndërkohë që kanë qenë të ulur në një prej lokaleve në bregun e lumit në rr. 13 Nëntori në Shkup. Rrahja masive ka ndodhur në QTQ Shkup ku janë thyer disa vitrina të dyqaneve. Tifozët janë goditur me shishe qelqi, metalike dhe objekte të tjera, pas kësaj “Tiranët” kanë vajtur drejt hotelit “Holidej in”. Në këtë incident është lënduar më rëndë një tifoz shkupjan, kurse janë lënduar më lehtë dy tifozë malazezë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 21 shkurt, ora 17:15, rr. “13 Nëntori” dhe QTQ Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Sport365 dhe gazeta ditore “Dnevnik”.

Viktimat e përfshira: 3 persona prej të cilëve një tifoz shkupjan i lënduar më rëndë dhe dy tifozë malazezë të lënduar më lehtë.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP), Lëndim i rëndë trupor (Neni 131, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Një numër i panjohur tifozësh të KF “Buduqnost” dhe të KF “Vardar”.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, që ka ndodhur gjatë një evenimenti sportiv, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - këtij incident i paraprin incidenti i një ditë më parë, kur tifozët e KF “Buduqnost” morën pjesë në rrahjen me tifozët e KF “Shkëndija”.
2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I panjohur. (Sipas informacioneve të transmetuara nga mediet janë arrestuar 23 tifozë të KF “Buduqnost” dhe u janë caktuar dënime me të holla).

Përgjigja e pushtetit lokal: Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, MPB-ja nuk i është përgjigjur Kërkesës për informacione publike të cilën Komiteti e ka dërguar në lidhje me këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe mjedisin shoqëror: Incidente të tilla e vënë në pikëpyetje gjendjen e

përgjithshme të sigurisë në shtet, bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri dhe sigurinë e njerëzve të pranishëm apo që janë në afërsi të ndeshjeve sportive.

19. Një i mitur ka sulmuar një djalosh dhe është kapur në autobus të NPQ-së (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një i mitur gjashtëmbëdhjetëvjeçar, i cili ka qenë me disa persona të tjerë, pa shkas dhe arsye e ka sulmuar fizikisht D.M. (21) nga Shkupi, duke e goditur në pjesën e fytyrës. Pas sulmit, i mituri, së bashku me personat e tjerë kanë hipur në autobus të NPQ-së me qëllim që të largohen nga vendngjarja, por është kapur dhe dërguar në SP nga nëpunësit policorë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 22 shkurt, rreth orës 20, "Kërste Petkov Misirkov" në Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Reporter.

Viktimat e përfshira: Një person.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerës: Një person i mitur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - incidenti ka ndodhur në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. Natyra e dhunës - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është dorëzuar kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Shkup është dorëzuar kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse më 1.3.2016 në Gjykatën Themelore Shkup 1 - Shkup, Sektori për kundërvajtje.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

20. Sulmohet fizikisht Todor Petrov (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Presidenti i Kongresit Botëror Maqedonas (KBM), Todor Petrov, është sulmuar fizikisht nga disa persona të panjohur pas shenjtërimit të gur-themelit të kryqit në lagjen Butel të Shkupit, ku ka marrë pjesë në shenjtërimin e themeleve të kryqit 51 metra të lartë, ndërtimi i të cilit është iniciativë e KBM-së. Sipas informacioneve të transmetuara nga mediet, Petrovit i është dhënë ndihma mjekësore në Qendrën e Urgjencës në Shkup.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 27 shkurt, ora 12:17, objekti "Kazablanka", Butel, Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Emagazin, gazeta ditore Dnevnik, Media elektronike, Lokalno, media nacionale televizive, Telma.

Viktimat e përfshira: Një person.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP)

Kryerës: Një grup prej disa kryerësish.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja fetare, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Perceptimi i viktimës - sipas deklaratës së dhënë për mediet, viktimat e konsideron incidentin si incident me motivim të anshëm.

2. Koha - incidenti ka ndodhur menjëherë pas shenjtërimit të gur-themelit të kryqit në Komunën e Butelit.

3. Vendndodhja - Incidenti ka ndodhur në rajonin e banuar me popullatë me përbërje etnike dhe përkatësi fetare të përzierë.

4. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

5. *Mungesa e motiveve të tjera*.

Statusi i rastit: Është dorëzuar fletëparaqitje kundër tre personave të dyshuar për sulmin.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Shkup është dorëzuar fletëparaqitje penale te Prokuroria Themelore Publike Shkup.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e bashkësive të ndryshme fetare në shtet.

21. Incident i përgjakur në Tetovë (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në oborin e gjimnazit “7 Marsi” në Tetovë ka ndodhur rrahje ku dy persona 19-vjeçarë nga Tetova kanë marrë lëndime. Sipas të dhënave të policisë në rrahje kanë marrë pjesë shtatë persona, prej të cilëve dy 19-vjeçarë dhe pesë 18-vjeçarë, të gjithë nga Tetova. Së pari midis dy grupeve ka nisur debat verbal që shpejt ka kaluar në rrahje midis tyre ku një person 19-vjeçar ka marrë dy plaga me thikë në kurriz, kurse moshatari i tij ka pësuar lëndim serioz në dorë prej goditjes. Të dyve u është dhënë ndihmë mjekësore në spitalin klinik në Tetovë, ku i lënduar me plagë në kurriz është mbajtur për mjekim të mëtejshëm.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 4 mars, ora 16:00, oborri i gjimnazit “7 Marsi” në Tetovë.

Burim i informacioneve: Televizioni 24 Vesti.

Viktimat e përfshira: Dy persona.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP).

Kryerës: Grup nxënësish nga gjimnazi “7 Marsi” .

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike – për shkak të përbërjes së përzierë etnike të nxënësve që mësojnë në shkollën e dhënë, ka mundësi që të dy grupet të kenë prejardhje të ndryshme etnike.
2. *Natyra e dhunës* – Incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen për kërkesën për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga SPB Tetovë është dorëzuar fletëparaqitje penale për veprën penale “Dhunë” në Prokurorinë Publike – Tetovë.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

22. I mituri sulmohet në Gjorçe Petrov (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në afërsi të SHF “Gjorçe Petrov” një 15 vjeçar i cili ka festuar ditëlindjen me shokët e vet, është ndaluar nga tre persona, prej të cilëve njëri ka pasur shkop bejsbolli. Tre personat janë nisur drejt të miturit dhe shokëve të tij dhe e kanë sulmuar fizikisht, njëri prej tre personave e ka zënë për qafe dhe e ka shtyrë drejt shkurreve, duke u përpjekur ta godasë me grusht, por i dëmtuari ka ikur dhe e ka paraqitur me telefon ngjarjen. Kur është nisur nga PS-ON “Gjorçe Petrov” një prej sulmuesve e ka marrë shkopin dhe është përpjekur ta godasë të dëmtuarin në pjesën e kokës, por nuk ia ka arritur qëllimit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 5 mars, rreth orës 21, në afërsi të SHF “Gjorçe Petrov” në Shkup.

Burim i informacioneve: Televizioni Sitell.

Viktimat e përfshira: Një person i mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Kërcënim me armë të rrezikshme gjatë rrahjes apo grindjes (Neni 133 KP).

Kryerës: Një grup prej tre kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - incidenti ka ndodhur në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Shkup është dorëzuar fletëparaqitje penale në Prokurorinë Themelore Publike - Shkup.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

23. Një i mitur lëndohet në Tetovë (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një i mitur 17 vjeçar nga Tetova, është sulmuar fizikisht nga tre persona të panjohur. Personi është dërguar në QK - Tetovë për dhënie të ndihmës mjekësore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 5 mars, rreth orës 12, në rr. Fushtanska, Tetovë.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Reporter.

Viktimat e përfshira: Një person i mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni130, KP)

Kryerës: Një grup prej tre kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - incidenti ka ndodhur në qytet me përbërje të përzierë etnike të popullsisë.

2. *Natyra e dhunës* - Incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se është kryer kontroll, pas kësaj është konstatuar se një ngjarje e tillë nuk është paraqitur në SP - Tetovë.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

24. Djem të sulmuar në Gjorçe Petrov (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy persona në moshë 18 dhe 19 vjeçare, pa shkas dhe arsye janë sulmuar fizikisht me grushte në fytyrë dhe trup nga disa persona të panjohur.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 9 mars, rreth orës 21, rr. "Gjorçe Petrov" në Shkup.

Burim i informacioneve: Televizioni Sitell.

Viktimat e përfshira: Dy persona.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP).

Kryerës: Grup prej disa kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - incidenti ka ndodhur në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Shkup është mbajtur procesverbal për praninë të fletëparaqitjes dhe janë marrë masat për zbardhje të kësaj shkeljeje.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

25. Një i mitur godit një të mitur tjetër në stacionin e autobusit (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një i mitur 17 vjeçar i ka shkaktuar plagë me thikë në kraharor një të mituri tjetër 16 vjeçar. Të njëjtit i është dhënë ndihmë mjekësore në SPQ “8 Shtatori”, ku i është konstatuar lëndimi trupor.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 12 mars, rreth orës 22, në stacionin e autobusit në bul. “Aradhat partizane” në Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Lokalno.

Viktimat e përfshira: Një person i mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim i rëndë trupor (Neni 131, PK), Pjesëmarrje në grindje (neni 132, KP).

Kryerës: Një person i mitur.

Përkthim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - për shkak të vendngjarjes së incidentit që ka ndodhur në një stacion autobusi, ku ndalojnë autobusë të cilët qarkullojnë në rajone me përbërje të përzierë etnike, ka mundësi që përkatësia etnike të jetë arsyeja e incidentit.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është dorëzuar kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB - Shkup është dorëzuar kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse më 24.3.2016 te Gjykata Themelore Shkup 1 - Shkup, Njësia për kundërvajtje.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

26. Dëmtohet autobusi i tifozëve të KF “Shkëndija” (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një kryerës i panjohur me një objekt të fortë e ka dëmtuar njërin xham të autobusit me targa të Tetovës. Në këtë autobus janë transportuar tifozët e KF “Shkëndija” nga Tetova. Në këtë incident nuk ka persona të lënduar. Sipas portalit “Iliria News”, sulmuesit kanë qenë përfaqësues të bashkësisë maqedonase.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 13 mars, rreth orës 13:40 në rr. “Metodija Andonov - Çento”, Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, MKD, Media elektronike, Iliria News.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - ka mundësi që incidenti të jetë shkaktuar nga tifozë me prejardhje të ndryshme etnike, prej tifozëve të cilët janë transportuar me këtë autobus.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB - Tetovë është mbajtur procesverbal për praninë të fletëparaqitjes penale për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja”, vepër e cila ndiqet me padi private dhe i njëjti është dorëzuar në SPB - Shkup, ku po ndërmerren masa për zbulim e kryerësve të veprës penale.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet dhe sigurinë e njerëzve të pranishëm apo në afërsi të ndeshjeve sportive.

27. Të mitur të lënduar nga rrahje te “Çairçanka” (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy djem shtatëmbëdhjetëvjeçarë, pas një zënke, janë sulmuar fizikisht nga një grup i panjohur të miturish, duke u shkaktuar lëndime trupore me objekt të fortë të panjohur. Të njëjtit janë dërguar në SPQ “Shën. Naumi i Ohrit” ku u është dhënë ndihmë mjekësore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 14 mars, rreth orës 13:30, në afërsi të QT “Çairçanka”, Shkup

Burim i informacioneve: Media elektronike, Kurir.

Viktimat e përfshira: Dy persona të mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Grup prej disa personash të mitur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - incidenti ka ndodhur në një objekt i cili gjendet në rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është dorëzuar fletëparaqitje penale.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB - Shkup është dorëzuar fletëparaqitje penale te Prokuroria Themelore Publike Shkup.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

28. Rrihet një nxënës në Kumanovë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: një i mitur 13 vjeçar, përfaqësues i bashkësisë etnike maqedonase është rrahur nga 7 nxënës përfaqësues të bashkësisë etnike shqiptare të një shkollë tjetër, ndërsa ka pritur autobus në stacionin e autobusit që të kthehet nga shkolla në shtëpi. I mituri është rrahur dhe goditur edhe pasi e ka humbur vetëdijen, duke marrë lëndime trupore. I mituri edhe një ditë më parë është shqetësuar nga njëri prej sulmuesve.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 22 mars, rreth orës 10, stacioni i autobusit në afërsi të shkollës “Toli Zordumis”, Kumanovë.

Burim i informacioneve: Televizioni Telma.

Viktimat e përfshira: Një person i mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Një grup prej 7 të miturish shqiptarë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - përbërja e përzierë etnike e nxënësve që mësojnë në shkollën në fjalë.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është dorëzuar kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB - Kumanovë te Gjykata Themelore Kumanovë, Gjykatësi për të mitur është dorëzuar Kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

29. Dëmtohen hapësirat partiake të PDSM-së në Kumanovë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës të panjohur e kanë demoluar shtabin partiak të *Partisë Demokratike të Serbëve në Maqedoni* (PDSM). Shtabi, sipas mbikëqyrjes parësore nuk është vjedhur, duke pasur parasysh se pajisja e tërësishme kompjuterike, printerët dhe projektorët janë në shtab, por i gjithë dokumentacioni është hedhur përreth.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 29 mars, rreth orës 23:30, Shtabi i PDSM-së, Kumanovë.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Kumanovski muabeti.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP), Shkaktim i urrejtjes, përçarjes apo mostolerancës në bazë të nacionalitetit, racës, fesë dhe bazës tjetër diskriminuese (neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi i partisë politike.

Statusi i rastit: Është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër një personi.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër një personi për shkak të ekzistimit të dyshimit se kanë kryer veprën penale "Vjedhje e rëndë". Mandej, në përgjigje thuhet se motivet për ngjarjet e lartpërmendura do të përcaktohen gjatë procedurës së mëtejshme.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

30. Djaloshi tetëmbëdhjetëvjeçar sulmohet në rrugë (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një person 18 vjeçar pa ndonjë shkas dhe arsye është sulmuar fizikisht prej dy sulmuesve të panjohur duke e goditur me një objekt prej gome në pjesën e kokës.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 30 mars, rreth orës 21:20, rr. "Bosnja dhe Hercegovina", Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, MKD.

Viktimat e përfshira: Një person.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Dy kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, ndërsa indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - incidenti ka ndodhur në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB - Shkup është bërë procesverbal për pranimin e fletëparaqitjes, kurse për ngjarjen po merren para për zbardhjen e shkeljes.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

31. I riu 17 vjeçar sulmohet në autobus (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një djalosh 17 vjeçar është sulmuar fizikisht në autobusin nr. 9, i cili qarkullonte në relacionin Fushë Topanë deri në Bit Pazar, nga disa persona të panjohur, dhe i janë shkaktuar lëndime trupore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 3 prill, rreth orës 13:45, autobusi nr. 9.

Burim i informacioneve: Media elektronike, MKD.

Viktimat e përfshira: Një person i mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Një grup i panjohur të rinjsh.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike - incidenti ka ndodhur në autobusin nr. 9 i cili qarkullon në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I mbyllur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga kontrolltet e kryera në evidencimet e SPB - Shkup, është konstatuar se personi i dëmtuar ka hequr dorë nga fletëparaqitja për sulm fizik të kryer, për të cilën është mbajtur edhe shënimi zyrtar nga SP KP - Bit Pazar për informacionin e marrë nëpërmjet bisedës së drejtpërdrejtë me qytetarin.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

32. Grabitet një refugjat në Vaksincë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Disa persona të panjohur kanë kryer grabitjen e një shtetas sirian. Personi ka dalë nga Qendra Pranuese Tabanovcë që të shkojë në dyqan në f. Vaksincë, por rrugën ia kanë zënë persona të cilët, duke iu kërcënuar për jetën e tij i kanë kërkuar para, pasi u ka thënë se nuk ka, e kanë sulmuar fizikisht dhe i kanë marrë 10 euro dhe 2.400 denarë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 26 prill, rreth orës 12:00, f. Vaksincë, Komuna Likovë.

Burim i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Viktimat e përfshira: Një sirian.

Lloji i krimit: Grabitje (Neni 237, KP).

Kryerës: Një grup prej disa kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme, viktimat janë përfaqësues të grupit (emigrantë sirianë) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga një inspektor i SPB - Kumanovë në PTHP Kumanovë është dorëzuar lajmërim më 13.5.2016 në lidhje me veprën penale “Grabitje” sipas nenit 237 paragrafi 1 i KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër vend.

33. Me plumb në këmbë plagoset një anëtar i KD-së të LSDM-së në Manastir (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Borçe Petkovski, anëtar i Këshillit Drejtues të LSDM-së në Manastir dhe ish-deputet, është plagosur me plumb në këmbë ndërsa ka biseduar me disa miq të vet duke qëndruar në trotuar. Ai është dërguar menjëherë në spitalin e Manastirit, ku pas intervenimit të kryer në mbigjurin e majtë, plumbi është nxjerrë. Nuk dihet a është gjuajtur mbi të apo incidenti ka ndodhur për shkak të gjuajtjes së pakontrolluar.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 27 prill, rreth orës 13, lagjja Karposh, Manastir.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Exclusive.mk.

Viktimat e përfshira: Një person.

Lloji i krimit: Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia dhe bindja politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Funksioni politik* - viktimë është funksionar i lartë në partinë më të madhe opozitare.

2. *Natyra e dhunës* - Incidenti ka ndodhur në publik

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale kundër një kryerësi të panjohur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes në SPB - Manastir është kryer mbikëqyrje e tërësishme dhe pas dokumentimit të tërësishëm është dorëzuar fletëparaqitje penale te Prokuroria Themelore Publike në Manastir kundër një kryerësi të panjohur, sepse ekzistojnë dyshime për kryerjen e veprës penale “Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm” që dënohet me nenin 288 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

34. Dëmtohet shtabi i VMRO-DPMNE-së në “Vostaniçka” (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në Shkup në rrugën “Vostaniçka” në objektin ku gjendet Shtabi i partisë politike VMRO-DPMNE, Shkup, nga disa persona të panjohur janë thyer xhamat e derës së hyrjes dhe xhamat anësore në të dyja anët e derës.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 30 prill, rreth orës 1:30, Shtabi i partisë politike VMRO-DPMNE në rrugën “Vostanička”, Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Reporter.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka pasur viktime.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi i partisë qeveritare.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Deri në momentin kur është shkruar ky raport, MPB nuk i është përgjigjur Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti e ka dërguar në lidhje me këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

35. Incident për shkak të bindjes politike (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Menjëherë pas protestës së LQMM-së në Manastir, një grup më i madh i qytetarëve të Manastirit janë drejtuar nga shtëpia e një prej udhëheqësve të “Lëvizjes së Manastirit”, aktivistit qytetar, Ilija Balltovski. Sipas dëshmitarëve, grupi ka thërritur fjalë të ndyta dhe sharje për Balltovskin, kanë thërritur “Ua!” dhe kanë fishkëlyer. Në atë kohë në shtëpi ka qenë familja e tij, e cila është shqetësuar, kurse Balltovski nuk ka qenë në shtëpi.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 10 maj, rreth orës 23:45, para shtëpisë së aktivistit qytetar, Ilija Balltovski, Lagjja Nedopirlivi, Manastir.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Sakam da kazham.

Viktimat e përfshira: Në këtë incident nuk ka viktime.

Lloji i krimit: Shkelje e rendit dhe qetësisë publike.

Kryerës: Një grup më i madh i qytetarëve të Manastirit.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtëpia e një aktivisti qytetar udhëheqës i të a.q. Lëvizja e Manastirit, e njohur në publik për pjesëmarrjen në demonstratat për dhënie dorëheqje të kryetarit të Komunës së Manastirit dhe tërheqjen e abolimit të presidentit, si dhe në grupin që ka realizuar aksione guerile në Manastir.

2. Perceptimi i viktimës - sipas deklaratës së dhënë për mediet, viktime e konsideron incidentin si incident me motivim të anshëm.

3. *Koha* - incidenti ka ndodhur drejtpërdrejt pas protestës së LQMM-së në Manastir.

Statusi i rastit: I mbyllur, nuk janë konstatuar shkelje apo vepra penale.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se gjatë protestës nuk janë konstatuar shkelje apo vepra penale për të cilat ndjekja merret me obligim zyrtar.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

36. Hapet me forcë Shtabi i LSDM-së (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës të panjohur e kanë hapur me forcë shtabin e LSDM-së në Shtip dhe kanë shkaktuar dëm të theksuar material, e kanë hedhur përtokë dhe e kanë nxjerrë jashtë të gjithë dokumentacionin e partisë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 10 maj, rreth orës 23:50, Shtabi partiak i LSDM-së në Shtip.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Meta Agjenci gazetareske.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi i partisë më të madhe opozitare.

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se për ngjarjen është informuar menjëherë Prokurori Publik i cili ka kryer mbikëqyrje të tërësishme në vendngjarje, kurse më pas nga SPB - Shtip është dorëzuar fletëparaqitje penale te Prokuroria Themelore Publike - Shtip për veprën pena "Vjedhje e rëndë" që dënohet me nenin 236 paragrafi 1 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

37. Hapen me forcë hapësirat e LSDM-së në Kisella Vodë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në hapësirat e organizatës komunale të LSDM-së në Kisella Vodë është kryer hyrje me dhunë nga kryerës të panjohur, dhe gjatë kësaj janë hapur me forcë gjashtë dyert e hapësirave, janë vjedhur tri lap-topa, dy kompjuterë dhe një projektor, kurse janë shkatërruar edhe dy kompjuterë prej të cilëve janë marrë hard-disqet dhe pjesët e tjera.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 23 maj, rreth orës 2:00, organizata komunale e LSDM-së në Kisella Vodë.

Burim i informacioneve: Gazeta ditore Utrinski vesnik.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Vjedhje e rëndë (Neni 236, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është organizata komunale e partisë më të madhe opozitare.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB - Shkup është dorëzuar procesverbal për mbikëqyrjen e kryer në Prokurorinë Themelore Publike - Shkup.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

38. Sulmohen emigrantë afër fshatit Dubrovë (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Pesë emigrantë janë sulmuar nga katër persona në f. Dubrovë. Më parë emigrantët janë takuar me personat të cilët u propozuan t'i dërgojnë deri në kufi me R e Serbisë me veturën "Audi", dhe për këtë shërbim u kanë kërkuar 1000 euro, por emigrantët kanë paguar 400 euro. Emigrantët janë futur në automjet të cilin e ka drejtuar njëri prej personave, duke u drejtuar kah Negotina. Menjëherë pas kësaj, në afërsi të fshatit Udovë, dy personat e tjerë të veshur me uniforma policie e kanë ndaluar automjetin ku kanë qenë emigrantët i kanë nxjerrë prej tij, i kanë shtrirë përtokë dhe kanë filluar t'i kontrollojnë duke u kërkuar para. Emigrantët i kanë kundërshtuar dhe kanë arritur t'ia marrin automjetin "Audi", personit të dytë, dhe më pas janë dhënë në arrati.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 7 qershor, rreth orës 22:00, f. Dubrovë.

Burim i informacioneve: Buletini ditore i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Viktimat e përfshira: Pesë emigrantë.

Lloji i krimit: Përpjekje për grabitje (Neni 237, KP); Mashtrim (Neni 247, KP); Paraqitje e rremë (Neni 391, KP).

Kryerës: Katër kryerës.

Përshkrimi i shkurtyr i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme, viktimat janë përfaqësues të grupit (emigrantë) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Janë ngritur fletëparaqitje penale kundër katër personave nga SPB -Veles.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes janë marrë masat nga SP KP Negotinë, në PTHP Kavadar është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër 4 personave E.E. (26) nga Gjermania, A.B. (36) nga Velesi, N.S: (23) nga Velesi dhe A.M. (20) nga Shkupi, sepse ekzistojnë baza dyshimi se i paraqituri i parë ka kryer tri vepra penale sipas nenit 247, paragrafi 1 i KP-së "mashtrim", neni 391 "prezantim i rremë" dhe neni 237 në lidhje me nenin 19 "përpjekje për grabitje", kurse tre të tjerët kanë kryer dy vepra penale sipas 391 "prezantim i rremë" dhe neni 237 në lidhje me nenin 19 "përpjekje për grabitje".

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër vend.

39. Goditet me gurë autobus në Bit-Pazar, lëndohet rëndë një tetëmbëdhjetëvjeçar (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Persona të panjohur kanë gjuajtur me gurë një autobus në Bit-Pazar. Një tetëmbëdhjetëvjeçar që gjendej në autobus është goditur me gur në kokë. Personi është dërguar menjëherë në Qendrën e Urgjencës ku është mbajtur për mjekim. Autobusi gjatë incidentit ka qarkulluar në drejtimin nga Qendra për në Autokomandë. Sipas informacioneve të MPB-së, incidenti ka ndodhur kur një grup personash të panjohur kanë gjuajtur me gurë autobusin me numër 50 të NPQ-së në stacionin e autobusit te hoteli "Sulltan" në bul. "Kërste Petkov Misirkov".

Data, koha dhe vendi i incidentit: 12 korrik, rreth orës 23:45, stacioni i autobusit te hoteli "Sulltan" në bul. "Kërste Petkov Misirkov", Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Telegraf.

Viktimat e përfshira: Një person tetëmbëdhjetëvjeçar.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Një grup prej disa kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - autobusi nr. 50 qarkullon nëpër një rajon të banuar me njerëz me prejardhje të përzierë etnike; stacioni i autobusit ku është goditur me gurë autobusi gjendet në rajon të banuar nga njerëz me prejardhje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se SPB - Shkup po ndërmer masa dhe aktivitete për zbardhjen e ngjarjes juridiko-penale dhe përcaktimin e identitetit të kryerësve, më pas do të vijojë shkresa përkatëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

40. Goditen me gurë katër automobila pas përfundimit të ndeshjes së futbollit Shkëndija dhe Mllada Bolesllav (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës të panjohur të maskuar kanë goditur me gurë katër automobila në lagjen e Shkupit, Gjorçe Petrov, menjëherë pas përfundimit të ndeshjes së futbollit midis KF "Shkëndija" dhe KF "Mllada Bolesllava" nga Çekia. Incidenti ka ndodhur kur kryerësit kanë filluar të hedhin objekte të ndryshme, gurë, pllaka begatoni, mbi katër automobilat. Siç informuan nga policia, janë goditur me gurë, automobil audi me targa të Tetovës, i drejtuar nga A.M. (31) nga f. Nerash të, automobil folksvagen pasat me targa të Tetovës i drejtuar nga A.M. (27) nga f. Përshvecë, automobil BMW me targa zvicerane, i drejtuar nga I.N. (42) nga f. Pallçishtë e poshtme dhe automobil audi 7, me targa gjermane, i drejtuar nga A.T. (41) nga Gostivari.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 28 korrik, rreth orës 22:00, rr. "Gjorçe Petrov", Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, MKD.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, i cili ka ndodhur pas një evenimenti sportiv, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - incidenti ka ndodhur në një rajon të populluar me njerëz me prejardhje të përzierë etnike, menjëherë pas përfundimit të ndeshjes së futbollit, ku mori pjesë një klub futbollit, tifozët e të cilit mund të kenë prejardhje etnike të ndryshme prej personave që jetojnë në rajonin ku ka ndodhur incidenti.

2. *Koha* - incidenti ka ndodhur menjëherë pas ndeshjes së futbollit, ku mori pjesë një klub futbollit, tifozët e të cilit mund të kenë prejardhje etnike të ndryshme prej personave që jetojnë në rajonin ku ka ndodhur incidenti.

Statusi i rastit: I mbyllur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se menjëherë pas paraqitjes së ngjarjes, nëpunës policorë nga SP KP "Gjorçe Petrov" kanë dalë në vendngjarje dhe kanë biseduar

me paraqitësin, ku ai ka thënë se nuk dëshiron të ngrejë fletëparaqitje dhe heq dorë nga procedura e mëtejshme.

Ndikimi mbi viktimat dhe mjedisin shoqëror: Incidente të llojeve të tilla e vënë në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në shtet, bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri dhe sigurinë e njerëzve të pranishëm apo në afërsi të ndeshjeve sportive.

41. Goditet me gurë një autobus në Gjorçe Petrov (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një person i panjohur ka goditur me gurë një autobus në lëvizje në relacionin Autokomandë - Saraj. Incidenti ka ndodhur kur një person i panjohur duke gjuajtur me gurë ka thyer shumë xhama të autobusit “Jugoton” të NPQ - Shkup në rrugën “Boris Sarafov” në Shkup. Incidenti ka ndodhur tri orë e gjysmë pasi janë goditur me gurë automobilat pas përfundimit të ndeshjes së futbollit midis KF “Shkëndija” dhe KF “Mllada Bolesllava”.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 29 korrik, rreth orës 00:30, rr. “Boris Sarafov”, Gjorçe Petrov, Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Pres 24.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - autobusi ka qarkulluar në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike, rruga prej nga është goditur me gurë autobusi gjendet në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

3. *Modeli i incidenteve të mëparshme* - gjatë së njëjtës natë, vetëm tri orë e gjysmë para këtij incidenti janë goditur me gurë katër automobila pas përfundimit të ndeshjes së futbollit midis KF “Shkëndija” dhe KF “Mllada Bolesllava”.

Kryerës: Të panjohur.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se më 5.8.2016 nga personi përgjegjës në NQP e SP KP “Gjorçe Petrov” është dorëzuar procesverbal për pranimin e fletëparaqitjes penale, si edhe se SPB - Shkup po ndërmer masa dhe aktivitet për zbardhjen e ngjarjes penalo-juridike dhe përcaktimin e identitetit të kryerësit, pas kësaj vijon shkresa konkrete.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

42. Dy sirianë janë sulmuar në rrugën nga Llojani për në Tabanovcë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy emigrantë nga Siria duke udhëtuar nga fshati Llojan për në QT “Tabanovcë”, janë sulmuar nga pesë persona të panjohur, dhe njërit i është shkaktuar prerje me thikë në krahun e majtë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 12 gusht, rreth orës 16:30, rruga: fshati Llojan -Tabanovcë.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Libertas.

Viktimat e përfshira: Dy shtetas sirianë.

Lloji i krimit: Lëndim trupor (Neni 130, KP); Dhunë (Neni 386, KP).

Kryerës: 5 kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është

prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme; viktimat janë përfaqësues të grupit (emigrantë sirianë) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti;

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes nga dy persona nga Siria të cilët janë strehuar në QT Tabanovcë, janë marrë masa nga nëpunësit policorë të SPB - Kumanovë, dhe është verifikuar se bëhet fjalë për shkelje të ligjit nëpërmjet “Sulmit fizik”. Për ngjarjen është informuar Prokurori publik nga PTHP - Kumanovë dhe lidhur me këtë po merren masat për zbardhje të tërësishme.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër vend.

43. Në autobus sulmohet një djalosh 16 vjeçar (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një i mitur 16 vjeçar është sulmuar në autobusin nr. 50 të NPQ-së nga dhjetë të mitur të tjerë, duke u goditur me pëllëmbë dhe i është vënë thika në pjesën e mesit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 15 shtator, rreth orës 13, në autobusin nr. 50 të NPQ-së, në relacionin nga Bit-Pazari deri në lagjen Autokomandë.

Burim i informacioneve: Gazeta ditore Nova Makedonija.

Viktimat e përfshira: Një person i mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP).

Kryerës: Një grup prej dhjetëra kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - kryerësit dhe viktimat kanë udhëtuar me autobusin nr. 50 i cili qarkullon nëpër një rajon të banuar me njerëz me prejardhje të përzierë etnike, ka mundësi që përkatësia etnike e kryerësit të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I mbyllur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se në deklaratën e dhënë para nëpunësve policorë në SP KP - Gazi Babë i dëmtuari ka deklaruar se nuk dëshiron të paraqesë çfarëdo lloj ngjarje dhe të dorëzojë procesverbal për pranim të fletëparaqitjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

44. Rrahje midis nxënësve në SHMN “Zdravko Cvetkovski” (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Nxënës të shkollës së mesme SHMN “Zdravko Cvetkovski” Shkup kanë sulmuar fizikisht dy të mitur nga e njëjta shkollë. Të miturit kanë marrë lëndime dhe janë dërguar në SPQ “8 Shtatori” për t’u dhënë ndihma mjekësore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 14 tetor, ora 17:45, SHMN “Zdravko Cvetkovski” Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, TV21mk.

Viktimat e përfshira: Dy persona të mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP); Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Një grup prej 3 nxënësish nga SHMN “Zdravko Cvetkovski”.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - për shkak të përbërjes së përzierë etnike në këtë shkollë ka mundësi që të dyja grupet të kenë prejardhje të ndryshme etnike.

2. *Natyra e dhunës* - Incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër tre personave.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se SPB Shkup ka dorëzuar fletëparaqitje penale kundër tre personave në PTHP-në kompetente.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

45. Fletëpalosje antisemite në qendër të Shkupit (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Fletëpalosje me mesazhe antisemite janë vendosur në disa automobila në qendër të Shkupit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 19 tetor, rreth orës 9, në qendër të Shkupit.

Burim i informacioneve: Incidenti në Komitetin e Helsinkit është paraqitur nga përfaqësuesi i *Bashkësisë Hebre në Republikën e Maqedonisë*.

Viktimat e përfshira: Në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Diskriminim racor dhe tjetër (Neni 417, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Përmbajtja e fletëpalosjeve* - fletëpalosjet përmbajnë mesazhe antisemite.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se ngjarja e dhënë nuk është paraqitur në stacion policor me kompetencë të përgjithshme për rajonin e Qytetit të Shkupit.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive të ndryshme në shtet.

46. Goditet me thikë një gjimnazist në autobusin e NQP-së nr. 65B (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në autobusin e NQP-së numër 65 B që ka qarkulluar në drejtim të fshatit Smilko-vcë të Shkupit, ndërkohë që një person i mitur 16 vjeçar nga fshati Creshevë, Shkup së bashku me disa persona të tjerë ishin në katin e dytë të autobusit. Në stacionin e autobusëve para pompës së benzinës në rr. “Metodija Andonov Çento” kanë hipur tre persona meshkuj në moshë nga 16 - 17 vjet dhe janë ulur afër të dëmtuarit. Në një moment një nga personat ka ardhur afër të dëmtuarit dhe e ka sulmuar fizikisht me grushte dhe shqelma, kurse më pas i janë bashkangjitur edhe personat e tjerë të cilët kanë vazhduar ta godasin, ta tërheqin zvarrë dhe keqtrajtojnë të dëmtuarin edhe një person tjetër. Një prej kryerësve që ka mbajtur thikë në dorë, e ka vendosur në qafën e një personi femër. Në atë moment i dëmtuari me qëllim që ta largojë kryerësin e ka shtyrë, ndërsa, pastaj, kryerësit me

thika kanë goditur atë dhe shokun e tij, duke i shkaktuar prerje në këmbën e djathtë. Pas një kohe të shkurtër pasi janë hapur dyert e autobusit, kryerësit kanë ikur.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 4 nëntor, ora 12:15, në autobusin e NQP-së numër 65 B.

Burim i informacioneve: Gazeta ditore Dnevnik; Buletini ditëor i MPB-së.

Viktimat e përfshira: Një person.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP); Lëndim trupor (Neni 131, KP); Rrezikim i sigurisë (Neni 144, KP).

Kryerës: Një person i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - kryerësit dhe viktimat kanë udhëtuar me autobusin nr. 65 B i cili qarkullon nëpër një rajon të banuar me njerëz me prejardhje të përzierë etnike, ka mundësi që përkatësia etnike e kryerësit të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është i fundit nga trendi rritës i dhunës në autobus të NQP-së nr. 65.

3. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se SPB - Shkup mori masa dhe aktivitete për përcaktimin e incidentit të kryerësit të shkeljes së rendit dhe qetësisë publike me sulm fizik, më pas do të vijojë shkresa përkatëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

47. Sulmohet një i ri në autobusin e NQP nr. 65 (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në SP KP - Gazi Babë, F.A. (18) nga fshati Creshovë – Shkup ka paraqitur se në të njëjtën ditë rreth orës 11:50 në rr. “Anton Popov”, më saktë në autobusin e NQP nr. 65, që ka qarkulluar në relacionin f. Rashtak - Shkup, është sulmuar fizikisht nga një person mashkull në moshë rreth 18 vjet, i cili e ka goditur me grusht në fytyrë dhe i ka shkaktuar lëndime të dukshme si ënjtje dhe skuqje. Sulmi fizik ka ndodhur pa shkas dhe arsye. Janë marrë masat për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 4 nëntor, ora 11:50, rr. “Anton Popov”, Shkup.

Burim i informacioneve: Pres24.

Viktimat e përfshira: Një person.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP); Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Një person

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - incidenti ka ndodhur në një rajon të banuar me njerëz me prejardhje të përzierë etnike, ka mundësi që përkatësia etnike e kryerësit të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, MPB-ja nuk i është përgjigjur Kërkesës për informacione publike të cilën Komiteti e ka dërguar në lidhje me këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

48. Dy fëmijë dyshohen për tentativë për vrasje (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Pas zënkës verbale, dy fëmijë 14 vjeçar i kanë shkaktuar goditje të rëndë trupore një personi 18 vjeçar në afërsi të lokalit “Stop” në rrugën “Bitpazar”. Fëmijët e kanë sulmuar personin me paramendim, e kanë goditur me grushte në kokë dhe në kraharor, nga këto goditje personi i dëmtuar ka rënë përtokë, duke marrë lëndim të rëndë trupor të llojit të çarjeve në kokë me dëmtim të trurit, gjakderdhje dhe mbushje të mushkërive me lëng. Nga plagët e marra, jetën e ka pasur në rrezik. Nga prokurori publik është kërkuar që të përcaktohet masa e paraburgim për të dy fëmijët.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 6 nëntor, ora 1:00, rr. “Bitpazarska”, Shkup.

Burim i informacioneve: Gazeta Ditore Fokus.

Viktimat e përfshira: Një person.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP); Lëndim i rëndë trupor (Neni 131, KP).

Kryerës: Dy persona të mitur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - incidenti ka ndodhur në një rajon të banuar me njerëz me prejardhje të përzierë etnike, ka mundësi që përkatësia etnike e kryerësit të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale kundër dy personave.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se SPB - Shkup ka dorëzuar fletëparaqitje penale kundër dy personave nga Shkupi në PTHP - Shkup.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

49. Janë thyer dritaret e shtabit të LSDM-së në Haraçinë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Nga kryerës të panjohur, në orët e hershme të mëngjesit janë thyer katër xhama dritaresh të Shtabit partiak të LSDM-së në Haraçinë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 7 nëntor, rreth orës 05:00, Shtabi partiak i LSDM-së në Haraçinë.

Burim i informacioneve: Televizioni Telma, Media elektronike, MKD.mk.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: I panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorët të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi i partisë më të madhe opozitare.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se SPB Shkup ndërmori masa dhe aktivitete për zbardhjen e ngjarjes juridike-penale dhe përcaktimin e identiteti të kryerësit.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

50. Dy djem rrihen në autobus në afërsi të Bit-Pazarit (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në afërsi të Bit-Pazarit, rreth orës 17, ndërkohë që autobusi i NQP-së nr. 50 ka qarkulluar nga Bit-Pazari drejt Qendrës, dhjetëra persona meshkuj të panjohur, në katin e sipërm të autobusit, kanë sulmuar fizikisht dy dem shtatëmbëdhjetëvjeçarë nga fshatrat Orman dhe Mirkovc. Sipas informacioneve të MPB-së, të dy të miturit kanë marrë lëndime të dukshme dhe ënjtje në fytyrë dhe trup.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 10 nëntor, rreth orës 17, ndërkohë që autobusi i NQP-së nr. 50 lëvizte në relacionin nga Bit-Pazari drejt Qendrës.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Plusinfo.

Viktimat e përfshira: Dy persona të mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP); Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Grup prej dhjetëra kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - kryerësit dhe viktimat kanë udhëtuar me autobus nr. 50 i cili qarkullon në një rajon të banuar me njerëz me prejardhje të përzierë etnike, ka mundësi që përkatësia etnike e kryerësit të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se SPB Shkup ndërmori masa dhe aktivitete për zbardhjen e prishjes së rendit dhe qetësisë publike, dhe më pas do të vijojë shkresa përkatëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

51. Dëmtohet fasada e Muzeut të alfabetit shqiptar në Manastir (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një kryerës i panjohur ka kryer dëmtim të fasadës së Muzeut të alfabetit shqiptar, pronësi e Ministrisë së Kulturës, duke e stërpikur me ngjyrë të zezë pllakën e mermerit dhe tabelën plastike në derën hyrëse të muzeut, kurse në murin afër derës hyrëse ka vizatuar kryqin nazist.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 13 nëntor, ora 11, Muzeu i alfabetit shqiptar, Manastir.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Mkd.mk.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përcarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia etnike, kurse indikatorët të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është Muzeu i alfabetit shqiptar, Manastir.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes dhe pas autorizimit të PP nga PTHP - Manastir, është kryer mbikëqyrje nga SPB - Manastir. Ngjarja në SPB - Manastir është regjistruar si vepër penale "Dëmtim i objekteve të huaja", për të cilën në përputhje me nenin 243 paragrafi 1 të KP-së ndjekja ndërmerret me padi private. Shtesë, në përgjigje thuhet se

po merren masa për zbardhje të tërësishme të rastit dhe zbulim të kryerësve.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

52. Grabitje të emigrantëve në afërsi të Bit-Pazarit (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy azilkërkuës, të vendosur në Qendrën Pranuese për Kërkuesit e Azilit në Vizbeg janë rrahur dhe grabitur në afërsi të Bit-Pazarit në Shkup nga katër persona të panjohur. Në trupat e emigrantëve ka pasur lëndime të dukshme, Pas grabitjes, sulmuesit kanë ikur në drejtim të panjohur. Rasti është paraqitur në polici, por nuk është shpallur në buletin ditor të MPB-së.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 17 nëntor, rreth orës 13:20, në afërsi të Bit-Pazarit, Shkup.

Burim i informacioneve: Përfaqësuese e organizatës joqeveritare Legis.

Viktimat e përfshira: Dy persona, azilkërkuës.

Lloji i krimit: Grabitje (Neni 237, KP); Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: 4 kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - prejardhja etnike e kryerësve dhe viktimave janë të ndryshme, viktimat janë përfaqësues të grupit (emigrantë, kërkues azili) i cili është mjaft më i vogël në numër se grupi i qytetarëve në rajonin ku ka ndodhur incidenti.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe sulmeve mbi emigrantët.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se ngjarja e ndodhur nuk është paraqitur në stacion policor me kompetencë të përgjithshme në rajonin e Qytetit të Shkupit.

53. Sulmohet përsëri Muzeu i alfabetit shqiptar (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në Ditën e Alfabetit Shqip, në orët e vona, kryerës të panjohur e kanë vandalizuar Muzeun e alfabetit shqiptar në Manastir. Kryerësit me pllaka begatoni i kanë thyer xhamat e derës hyrëse të muzeut, kurse në të, kanë ngjitur poster në të cilin ka një luan me shtatë i cili ia pret kokën shqiponjës dykrenore dhe shkruan “Vdekje për shqiptarët” (Smrt za shqiptari). Mbi pllakën përkujtimore është vendosur edhe një poster ku shkruhej “Stop për shqiptarizimin” (Stop za shiptarizacijata) dhe është shkarravitur simboli nacional shqiptar, përkatësisht shqiponja dykrenore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 21 nëntor, rreth orës 23, Muzeu i alfabetit shqiptar, Manastir.

Burim i informacioneve: Media elektronike, MKD.mk; SKD.mk; 24vesti; TV Tera.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: 2 kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është Muzeu i alfabetit shqiptar, Manastir;

2. *Koha* - incidenti ka ndodhur natën e 22 nëntorit, Ditën e Alfabetit Shqiptar;

3. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky është sulmi i dytë mbi Muzeun e alfabetit shqiptar në një periudhë prej dhjetë ditësh.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes dhe pas autorizimit të PP-së nga PTHP - Manastir, është kryer mbikëqyrje nga SPB - Manastir. Ngjarja në SPB - Manastir është regjistruar si vepër penale “Dëmtim i objekteve të huaja”, për të cilën në përputhje me nenin 243 paragrafi 1 të KP-së ndjekja ndërmerret me padi private. Për ngjarjen e paraqitur janë parë regjistrimet e kamerave mbikëqyrëse, ku janë vënë re dy persona meshkuj. Shtesë, në përgjigje thuhet se po merren masa për zbardhje të tërësishme të rastit dhe zbulim të kryerësve.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

54. Janë thyer xhamat e Shtabit të VMRO-DPMNE-së në Negotinë (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës të panjohur kanë dëmtuar xhamat e hapësirave të Komitetit Vendor të VMRO-DPMNE-së.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 23 nëntor, në orët e vona të natës, Shtabi partiak i VMRO-DPMNE-së në rrugën “Marshall Tito” në Negotinë.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Telegraf.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi partiak i partisë në pushtet.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes është kryer mbikëqyrje dhe për të njëjtën është dorëzuar lajmërim në PTHP - Kavadar.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

55. Është dëmtuar Shtabi i VMRO-DPMNE-së në Negotinë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës të panjohur kanë dëmtuar xhamat e hapësirave të Komitetit vendor të VMRO-DPMNE-së në rrugën “Partizanska” në Negotinë. Kjo është hera e dytë e dëmtimit të shtabit të kësaj partie në Negotinë, pasi më parë janë thyer xhamat e një shtabi tjetër partiak në rrugën “Mareshal Tito”.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 23 nëntor, në orët e vona të natës, Shtabi partiak i VMRO-DPMNE-së në Negotinë.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Telegraf.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. Lokacioni qëllimor - lokacioni qëllimor është shtabi partiak i partisë në pushtet.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes është kryer mbikëqyrje dhe për të njëjtën është dorëzuar lajmërim në PTHP - Kavadar.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

56. Janë rrahur të mitur në afërsi të Bit-Pazarit (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy nxënës shtatëmbëdhjetëvjeçarë nga SHMQSH “Vllado Tasevski” janë sulmuar fizikisht nga 10 deri në 15 persona të panjohur, nxënës në të njëjtën shkollë. Menjëherë pas sulmit fizik, kryerësit kanë zbritur nga autobusi i NQP-së nr. 50. Nga mjeku te të dy personat e mitur janë konstatuar lëndime trupore, kurse një person është mbajtur për mjekim të mëtejshëm.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 23 nëntor, ora 14:30, në afërsi të Bit-Pazarit, Shkup

Burim i informacioneve: Media elektronike, Makfaks.

Viktimat e përfshira: Dy persona të mitur.

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP); Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Grup prej dhjetë kryerësish.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike - për shkak të përbërjes së përzierë etnike të nxënësve që mësojnë në shkollën e dhënë, ka mundësi që kryerësit dhe viktimat të kenë prejardhje të ndryshme etnike.

2. Natyra e dhunës - Incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se më 5.8.2016 personi përgjegjës nga NQP në SP KP - Gjorçe Petrov është dorëzuar procesverbal për pranimin e fletëparaqitjes penale, si dhe se SPB - Shkup ndërmori masa dhe aktivitetet për zbardhjen e ngjarjes penalo-juridike dhe përcaktimin e identitetit të kryerësit, pas kësaj do të vijojë shkresa konkrete.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

57. Dëmtohet një bilbord i BDI-së në Kumanovë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës i panjohur ka dëmtuar një bilbord ku është vendosur material propagandues i BDI-së, në rrugën “JNA”, në Kumanovë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 25 nëntor, rreth orës 12:30, rr. JNA, Kumanovë.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Kumanovonews.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. Objekt i dëmtuar - në bilbord ka pasur material propagandues të partisë politike BDI.

2. Model i incidenteve të mëparshme - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të

bilbordeve me përmbajtje politike në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, MPB-ja nuk i është përgjigjur Kërkesës për informacione publike të cilën Komiteti e ka dërguar në lidhje me këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

58. Dëmtohet një bilbord i BDI-së në Kumanovë (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës i panjohur ka dëmtuar një bilbord ku është vendosur material propagandues i BDI-së në udhëkryqin e rrugëve “11 Tetori” dhe “11 Nëntori” në Kumanovë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 25 nëntor, rreth orës 12:30, udhëkryqi i rrugëve “11 Tetori” dhe “11 Nëntori”, Kumanovë.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Kumanovonews.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. Objekt i dëmtuar - në bilbord ka pasur material propagandues të partisë politike BDI.

2. Model i incidenteve të mëparshme - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të bilbordeve me përmbajtje politike në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes nga SP-ja e SPB - Kumanovë është kryer mbikëqyrje e bilbordit të vendosur në rr. “11 Tetori” dhe “11 Nëntori” në Kumanovë, ku është konstatuar se nga kryerës i panjohur / të panjohur është grisur pllakati i vendosur në bilbord. Ngjarja është foto dokumentuar nga ekipi i kontrollit në SPB - Kumanovë dhe për të është informuar prokurori publik i PTHP-së, Kumanovë. Shtesë, në përgjigje thuhet se po merren masat për zbardhje të tërësishme të rastit.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

59. Digjet bilbordi i partisë politike Lëvizja BESA (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Gjatë natës, në lagjen Gjorçe Petrov, kryerës të panjohur kanë ndezur bilbord në të cilin ka pasur material reklamues të partisë politike Lëvizja BESA. Sipas Orhan Murtezanit, zëdhënës i partisë, ky incident është shkaktuar nga “armiku i shqiptarëve”.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 25 nëntor, në orët e natës, lagja Gjorçe Petrov, Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Libertas.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: I panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. Objekt i dëmtuar - në bilbord ka pasur material propagandues të partisë politike Lëvizja BESA.
2. Model i incidenteve të mëparshme - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të bilbordeve me përmbajtje politike në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se ngjarja e ndodhur nuk është paraqitur në stacionin policor të kompetencës së përgjithshme në rajonin e Qytetit të Shkupit.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet, si dhe bashkëjetesën midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

60. Digjen pjesërisht dy bilborde me fotografi nga fushata e BDI-së (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në lagjen Gjorçe Petrov, kryerës i panjohur ka djegur pjesërisht dy bilborde me fotografi të përfaqësuesve të partisë politike BDI.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 25 nëntor, rreth orës 14:25, në udhëkryqin midis rr. "Gjorçe Petrov"; dhe rr. "Kuzman Shapkarev" në lagjen Gjorçe Petrov në Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Skopjeinfo.mk.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. Objekt i dëmtuar - në bilbord ka pasur material propagandues të partisë politike BDI.
2. Model i incidenteve të mëparshme - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të bilbordeve me përmbajtje politike në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se SPB Shkup ndërmerr masa dhe aktivitete për zbardhjen e ngjarjes juridike-penale dhe përcaktimin e personave të përfshirë, pas kësaj do të vijojë shkresa përkatëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

61. Dëmtohet shtabi i VMRO-DPMNE-së në Kavadar (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Nga kryerës të panjohur është dëmtuar shtabi i partisë politike VMRO-DPMNE, gjatë kësaj janë thyer xhamat e dritares nga ana e pasme e objektit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 25 nëntor, rreth orës 23:30, rr. Mosha Pijade, Kavadar.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Telegraf.mk.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. Lokacioni qëllimor - lokacioni qëllimor është shtabi partiak i partisë në pushtet.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të bilbordeve me përmbajtje politike në periudhën parazgjedhore

Statusi i rastit: I mbyllur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes, nga ST KP - Kavadar është kryer mbikëqyrje në vendngjarje dhe është konstatuar se bëhet fjalë për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja” (neni 243 i KP-së), me që kjo vepër penale ndiqet me padi private nuk është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër kryerësit të panjohur në PTHP.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

62. Goditet me gurë autobusi nr. 65 i NQP-së, është lënduar një djalë 17vjeçar (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një shtatëmbëdhjetëvjeçar nga fshati Bullaçan, Shkup është goditur në kokë kur autobusi i NQP-së nr. 65, me të cilin po udhëtonte, është qëlluar me gurë nga kryerës i panjohur. Me automjet të urgjencës mjekësore është dërguar në spitalin “Shën. Naumi i Ohrit”, ku janë konstatuar lëndime trupore dhe është mbajtur për mjekim të mëtejshëm. Shoferi i autobusit, në Stacionin Policor “Gazi Babë” ka paraqitur se kur e ka drejtuar autobusin, i cili qarkullon në linjën e rregullt nr. 65, kryerës i panjohur ka gjuajtur me gur në drejtim të autobusit dhe ka thyer një prej dritareve në katin e dytë. Në buletinin ditor të MPB-së thuhet se po ndërmerren masa për gjetjen e autorit dhe zbardhjen e tërësishme të rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 29 nëntor, rreth 21:55, autobusi i NQP-së nr. 65 i cili lëvizte në rr. “Metodija Andonov Çento” dhe rr. “Palmiro Tolati”, Shkup.

Burim i informacioneve: TV Alsat.

Viktimat e përfshira: Një person shtatëmbëdhjetëvjeçar.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Kryerës i panjohur.

Përkthim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - autobusi nr. 65 qarkullon në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike, vendi ku është gjuajtur me gurë autobusi gjendet në rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky është incidenti i fundit i trendit të zmadhuar të goditjes me gurë të autobusit të NQP-së nr. 65.

3. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, MPB-ja nuk i është përgjigjur Kërkesës për informacione publike të cilën Komiteti e ka dërguar në lidhje me këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

63. Rrezikimi i sigurisë në Shtabin e LSDM-së në Koçan (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Persona të panjohur kanë hyrë me forcë në shtabin zgjedhor të OK-së së LSDM-së i vendosur në “Shoping-qendrën”- Koçan, ku kanë qenë të pranishëm katër anëtarë, dhe u janë kërcënuar me forcë fizike. Një prej personave e hoqi materialin zgjedhor, pllakat i cili ishte vendosur në vitrinën e shtabit, e ka hedhur në kuti kartoni dhe është larguar. Në buletinin ditor të MPB-së

thuhet se po merren masat për gjetjen e kryerësve dhe për zbardhjen e tërësishme të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 30 nëntor, ora 18:55, Shtabi zgjedhor i OK-së së LSDM-së i vendosur në "Shopping-qendrën"- Koçan.

Burim i informacioneve: Buletini ditor i MPB-së.

Viktimat e përfshira: Katër persona.

Lloji i krimit: Rrezikim i sigurisë (Neni 144, KP).

Kryerës: Një grup kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi i partisë më të madhe opozitare.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të shtabeve partiake në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se pas paraqitjes së ngjarjes dhe pas autorizimit të prokurorit publik nga ekipi hetimor i Zyrës së Jashtme për Punë Kriminale, Koçan është kryer hetimi. Është kryer bisedë me dëshmitar në ngjarje, për masat e marra është informuar edhe Prokurori publik themelor në Koçan, nga i cili është konstatuar se ekzistojnë elementë të veprës penale sipas nenit 392 paragrafi 1 i KP-së, përkatësisht, autokraci e cila ndiqet me padi private. Ngjarja është paraqitur edhe në PTHP - Koçan, kështu që nga PP është dhënë urdhri për ndërmarrjen e masave pas ngjarjes së paraqitur. Pas veprimit, sipas urdhrin, materiali i tërësishëm në lidhje me ngjarjen është dorëzuar në PTHP.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

64. Goditet përsëri me gurë autobus i NQP-së, lëndohet shoferi (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Personi I.R. nga fshati Haraçinë, shofer i autobusit nr. 65 i NQP-së Shkup, nëpërmjet telefonit në MPB ka paraqitur se në rr. "Metodija Andonov-Çento" në afërsi të vendit të quajtur "Tri kuqi", ndërsa ka drejtuar autobusin, një kryerës i panjohur ka gjuajtur pllakë bekaton në xhamin përpara. I.R. ka pësuar lëndime në pjesën e syve dhe është dërguar në Qendrën Klinike "Nënë Tereza". Pas dhënies së ndihmës është lëshuar në mjekim shtëpiak.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 1 dhjetor, ora 22:00, në autobusin e NQP-së nr. 65 i cili gjendej në rr. "Metodija Andonov-Çento" në afërsi të vendit të quajtur "Tri kuqi".

Burim i informacioneve: Media elektronike, Republika.mk.

Viktimat e përfshira: Një person.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Lëndim trupor (Neni 130, KP).

Kryerës: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar i prejardhjes etnike* - Autobusi nr. 65 qarkullon në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike, vendi ku është gjuajtur me gurë autobusi gjendet në rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky është incidenti i fundit i trendit të zmadhuar të goditjes me gurë të autobusit të NQP-së nr. 65.

3. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se SPB - Shkup ndërmori masa dhe aktivitete për zbardhje e ngjarjes juridike-penale “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm” dhe përcaktimin e identitetit të kryerësit, më pas do të vijojë shkresa përkatëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

65. Thyhen dritaret e Shtabit të Lëvizjes BESA (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në orët e natës, në kohë të papërcaktuar qartë, nga kryerës të panjohur, me gur është kryer dëmtimi i xhamit të parë të shtabit parazgjedhor të partisë politike Lëvizja BESA në fshatin Sllatinë, Komuna Tearcë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 6 dhjetor, në orët e natës, Shtabit partiak i Lëvizjes BESA në fshatin Sllatinë, Komuna Tearcë.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Lokalno.mk; Fax.al.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është Shtabi parazgjedhor i partisë politike Lëvizja BESA.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të shtabeve partiake në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB - Tetovë është kryer mbikëqyrje në vendngjarje, është informuar prokurori publik, sipas të cilit ngjarja e paraqitur është vepër e cila ndiqet me padi private.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

66. Shkatërrohet Shtabi i LSDM-së në fshatin Viniçe (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Gjatë orëve të pasdites është shkatërruar Shtabi i partisë politike LSDM, afër kishës në fshatin Viniçe. Një kryerës i panjohur me përdorim të forcës ka thyer derën hyrëse të objektit, ka hyrë brenda, ka bërë rrëmujë, ka hedhur përtokë materiali reklamues, ndërsa një pjesë e ka marrë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 7 dhjetor, rreth orës 17:52, Shtabi partiak i LSDM-së në fsh. Viniçe.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Lokalno.mk

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi i partisë më të madhe opozitare.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të

shtabeve partiake në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: I mbyllur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se paraqitësi është informuar se duhet të dorëzojë procesverbal në stacionin kompetent policor, por i njëjti nuk ka dorëzuar fletëparaqitje me shkrim.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

67. Digjet bilbordi i BDI-së në lagjen Gjorçe Petrov (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në lagjen Gjorçe Petrov, nga kryerës i panjohur janë djegur pjesërisht dy bilborde me fotografi të përfaqësuesve të partisë politike BDI.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 8 dhjetor, rreth orës 03:00, në rr. “Gjorçe Petrov”, tek ish “Baumar- ket”, Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Lokalno.mk.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. Objekt i dëmtuar - në bilbord ka pasur material propagandues të partisë politike BDI.

2. Model i incidenteve të mëparshme - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të bilbordeve me përmbajtje politike në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Shkup, Njësia për mbikëqyrje në vendngjarje dhe analizë ka bërë fotografim, kurse të dëmtuarit janë informuar se vepra penale e kryer “Dëmtim i objekteve të huaja” ndiqet me padi private dhe për të duhet të dorëzohet procesverbal te stacioni kompetent policor.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

68. Thyhet dritarja e një shtabi partiak në lagjen Kozle (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në periudhën nga 11.12.2016 deri më 13.12.2016 në rr. “Kozle-1” në objektin e një partie politike, një kryerës i panjohur ka thyer xhamin e dritares. Sipas informacioneve të transmetuara në medie po merren masat për gjetjen e kryerësit dhe për zbardhjen e të gjithë rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: Nga 11.12.2016 deri më 13.12.2016 shtabi partiak i një partie politike në lagjen Kozle.

Burim i informacioneve: TV Sitel.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është

përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi i një partie politike.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i dëmtimit të shtabeve partiake në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se i dëmtuari është informuar se vepra penale e kryer “Dëmtim i objekteve të huaja” ndiqet me padi private dhe për të duhet të dorëzohet procesverbal te stacioni kompetent policor, pas kësaj ai është kontaktuar disa herë nga nëpunësit policorë në SP KP - Karposh.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

69. Vjedhje në një shtab partiak në Kavadar (e paverifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Një kryerës i panjohur ka kryer vjedhje të rëndë te shtabi i një partie politike në Kavadar. Kryerësi ka hyrë dhe ka marrë disa pako me ujë dhe lëngje, një radiator të vogël dhe aparat për kafe. Sipas informacioneve të dhëna nga mediet, po ndërmerren masat për gjetjen e kryerësit dhe për zbardhjen e tërësishme të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: Midis 12.12 dhe 13.12.2016, shtabi partiak i një partie politike në Kavadar.

Burim i informacioneve: Media elektronike, Libertas.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Vjedhje e rëndë (Neni 236, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi partiak i një partie politike.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe dëmtimit të shtabeve partiake në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: I mbyllur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SP KP - Kavadar është kryer hetim në vendngjarje dhe është konstatuar se bëhet fjalë për veprën penale “Vjedhje” (neni 235, zëri 2 i KP-së), me që, kjo veprë penale ndiqet me padi private nuk është ngritur fletëparaqitje penale kundër kryerësit të panjohur në PTHP.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

70. Dëmtohet Shtabi i LSDM-së në Bardovc (e verifikuar)

Çfarë ka ndodhur: Në orët e mëngjesit, një kryerës i panjohur ka dëmtuar Shtabin e partisë politike LSDM në fshatin Bardovc. Kryerësi i panjohur ka thyer me gur dy xhama të objektit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 14 dhjetor, Shtabi partiak i LSDM-së në Bardovc, Shkup.

Burim i informacioneve: Media elektronike, 24vesti.

Viktimat e përfshira: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimit: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP); Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë nacionale, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese (Neni 319, KP).

Kryerës: Kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Lokacioni qëllimor* - lokacioni qëllimor është shtabi i partisë më të madhe opozitare.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është ndjekur nga trendi i zmadhuar i vjedhjeve dhe dëmtimit të shtabeve partiake në periudhën parazgjedhore.

Statusi i rastit: I mbyllur.

Përgjigja e pushtetit lokal: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se i dëmtuari është informuar se vepra penale e kryer “Dëmtim i objekteve të huaja” ndiqet me padi private dhe për të duhet të dorëzohet procesverbal te stacioni policor kompetent, pas kësaj ai është kontaktuar disa herë nga nëpunësit policorë në SP KP - Karposh, dhe më pas ka deklaruar se nuk dëshiron të ngrejë fletëparaqitje dhe se heq dorë nga procedura e mëtejshme.

Ndikimi mbi viktimat dhe mbi mjedisin shoqëror: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.